REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

Berat më ____/____/2023

RELACION

PËR SHTESË NË BUXHETIN E VITIT 2023 TË BASHKISË BERAT ME FONDIN PËR RRITJEN E PAGAVE NË ZBATIM TË VENDIMIT NR. 328, DATË 31.05.2023

Të nderuar këshilltarë !
Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.328 datë 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar , të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore",
Bashkisë Berat, me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.12674 datë 10.07.2023 "Dërgohet akordimi i fondit për rritjen e pagave në zbatim të Vendimit nr. 328, datë 31.05.2023", i është akorduar fondi prej 17,533,008 lekë si Transfertë korrente e brendshme (art. 604) , për rritjen e pagave të punonjësve të cilët preken nga ky vendim.

Është e nevojshme që ky fond të detajohet në zërat e shpenzimeve Paga dhe Sigurime Shoqërore&Shëndetësore, si edhe të rishpërndahet dhe shtohet në buxhetin e vitit 2023 të njësive shpenzuese :

1. Bashkia Berat (qendra), total shtesa 4,522,303 lekë, nga të cilat: në programin buxhetor 01110 "Planifikim, menaxhim dhe administrim" shuma 3,501,000 lekë , në programin buxhetor 10430 "Përkujdesja Sociale" shuma 1,021,303 lekë.

2. Agjencia e Shërbimeve Publike , total shtesa 5,085,000 lekë, nga të cilat: në programin buxhetor 04520"Rrjeti rrugor rural" shuma 2,685,000 lekë , në programin buxhetor 06260 "Shërbimet publike vendore" shuma 2,400,000 lekë.

3. Drejtoria Arsimore Bashkia Berat, total shtesa 6,765,705 lekë, nga të cilat: në programin buxhetor 09120 "Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor" shuma 5,464,500 lekë, në programin buxhetor 09230 "Arsimi i mesëm i përgjithshëm/parauniversitar" shuma 641,850 lekë, në programin buxhetor 10430 "Përkujdesja Sociale" shuma 659,355 lekë

4. Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve , Ujërave dhe Shërbimit Veterinar, total shtesa 1,160,000 lekë, nga të cilat: në programin buxhetor 04240 "Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit" shuma 750,000 lekë, dhe në programin buxhetor 04260 "Administrimi i pyjeve dhe kullotave" shuma 410,000 lekë.

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 54, gërma "dh", neni 64 gërma "c", ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar , të ligjit nr. 84/2022 "Për Buxhetin e vitit 2023", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimit plotësues nr. 2 datë 19.01.2023 të Ministrit të Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023"; Vendimit e Këshillit Bashkiak nr 100 datë 22.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2023 dhe PBA 2023-2025" i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.328 datë 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar , të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.

12674 datë 10.07.2023 "Dërgohet akordimi i fondit për rritjen e pagave në zbatim të Vendimit nr. 328, datë 31.05.2023",
propozojmë që në VKB nr 100 datë 22.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2023 dhe PBA 2023-2025" i ndryshuar , të bëhet shtesa e buxhetit të vitit 2023 si më poshtë :
1. Të shtohet buxheti i vitit 2023 me 17,533,008 lekë me fondin për rritjen e pagave në zbatim të Vendimit nr. 328, datë 31.05.2023.

Detajimi i shtesës së buxhetit :
Shtesë:

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Llogaria	Kod Projekti	Pershkrimi	Shuma LEK
2102001	**Bashkia Berat (Aparati)**					**4,522,303**
		01110	**Planifikim, menaxhim dhe administrim**			**3,501,000**
2102001	01	01110	600	9999999	Paga	3,000,000
2102001	01	01110	601	9999999	Sigurime shoqerore	501,000
		10430	**Përkujdesja Sociale**			**1,021,303**
2102001	01	10430	600	9999999	Paga	862,000
2102001	01	10430	601	9999999	Sigurime shoqerore	159,303
2102004	**Agjencia e Shërbimeve Publike**					**5,085,000**
		04520	**Rrjeti rrugor rural**			**2,685,000**
2102004	01	04520	600	9999999	Paga	2,300,000
2102004	01	04520	601	9999999	Sigurime shoqerore	385,000
		06260	**Shërbimet publike vendore**			**2,400,000**
2102004	01	06260	600	9999999	Paga	1,500,000
2102004	01	06260	601	9999999	Sigurime shoqerore	900,000
2102005	**Drejtoria Arsimore Bashkia Berat**					**6,765,705**
		09120	**Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor**			**5,464,500**
2102005	01	09120	600	9999999	Paga	4,650,000
2102005	01	09120	601	9999999	Sigurime shoqerore	814,500
		09230	**Arsimi i mesëm i përgjithshëm**			**641,850**
2102005	01	09230	600	9999999	Paga	550,000
2102005	01	09230	601	9999999	Sigurime shoqerore	91,850
		10430	**Përkujdesja Sociale**			**659,355**
2102005	01	10430	600	9999999	Paga	565,000
2102005	01	10430	601	9999999	Sigurime shoqerore	94,355
2102022	**Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve , Ujërave dhe Shërbimit Veterinar**					**1,160,000**
		04240	**Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit**			**750,000**
2102022	01	04240	600	9999999	Paga	600,000
2102022	01	04240	601	9999999	Sigurime shoqerore	150,000
		04260	**Administrimi i pyjeve dhe kullotave**			**410,000**
2102022	01	04260	600	9999999	Paga	320,000
2102022	01	04260	601	9999999	Sigurime shoqerore	90,000
					Totali i Shtesave	**17,533,008**

Ju faleminderit !

KRYETAR

Ervin DEMO

Agjencia e Shërbimeve Publike

Drejtoria Arsimore Bashkia Berat

Drejtoria e Bujqësisë

Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave

Drejtoria Juridike

RELACION

MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR TË BUXHETIT TË SHTETIT TË MBROJTJES CIVILE

Të nderuar këshilltarë!

Nisur nga verifikimet në teren të zonave të riskut të cilat përbejnë rezik për jetën e qytetarëve, si dhe kërkesave të vazhdueshme të tyre për rrezikshmërinë që paraqesin muret mbajtëse të rrugëve në lagjen "28 Nëntori" dhe lagjen "Donika Kastrioti",të Bashkisë Berat konkretisht :

- Lagjja " 28 Nëntori " Rajoni nr 2, ka patur rrëshqitje të rrugës së lagjes ku kalojnë disa familje . Si pasojë e rrëshqitjes në një gjatësi prej 17 ml rruga aktualisht është bërë e pakalueshme për automjetet e vogla të cilat janë shume të domosdoshme pasi ne kete rrugë kalojnë familje që kanë persona me aftësi të kufizuar .siç është rasti i familjes së Xhela Bregut.
  Shembja e murit ekzistues të kësaj rruge ka rrezikuar edhe banesën e znj.Monda Shabanit siç duket edhe nga fotot që janë bashkëlidhur relacionit.

- Lagjja " Donika Kastrioti " , Rruga "Vangjel Zoto" Rajoni 3 kemi rrëshqitje të aksit të rrugës në gjatësinë prej 20ml ,si rezultat i terrenit dhe kalimit të automjeteve të vogla dhe të mëdha . Dëmtimi i rrugës po vazhdon akoma prandaj del e nevojshme ndërtimi i murit mbajtës të kësaj rruge .

Në mbështetje të ligjit nr 45/2019 " Për mbrojtjen civile" dhe të VKM nr 414 datë 08.07.2021 " Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" pika 3.1 gërma b, pika 5 , shkresës së Ministrisë së Mrojtjes nr 86/6 prot datë 27.03.2023" Mbi akordimin e fondeve të kushtëzuara për vitin 2023" ku Bashkise Berat i është akorduar fondi në

shumën 12,669,893.43 lekë, ju sjellim propozimet tona për të përdorur fondin e akorduar nga buxheti i shtetit për mbrojtjen civile si më poshtë :

- të përdoret shuma 269,275.00 (dyqind e gjashtedhjet e nëntë mije e dyqind e shtadhjet e pese) lekë për projektin " Mur mbajtes Rruga "Vangjel Zoto"", dhe 529,214.00 (pesëqind e njëzet e nëntë mijë e dyqind e katërmbëdhjet) lekë sipas preventivave bashkangjitur relacionit.

Këto ndërhyrje shërbejnë për marrjen e masave parandaluese, mos lejimit e shkatërrimit të mëtejshëm të rrugëve dhe rikthimin e jetës normale për komunitetin dhe veprimtaritë e tij ekonomike , në përputhje me pikën 3.1 gërma b të VKM-së.

Ju faleminderit,

KRYETARI I BASHKISË

Ervin DEMO

Drejtoria e MCPTSH

Drejtoria e PULMI

Drejtoria Juridike

Drejtoria e Menaxhimit Financiar

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

R E L A C I O N

“MBI MIRATIMIN E FONDEVE PËR NDËRHYRJEN EMERGJENTE TË PROJEKTIT ”NDËRTIMI I SHPATULLAVE TË URES NË FSHATIN LAPARDHA”

Të nderuar Këshilltarë!

Në bazë të VKM 753 datë 09/12/2021 për shpronësimin për interesa publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, po realizohet projekti për kthimin e Bazës Ajrore Kuçovë, në Bazë Ajrore Taktike të NATO-s. Nga ky projekt u prekën shumë toka bujqësore të fshatit Moravë, nga të cilat rreth 25 ha tokë bujqësore dhe 2.2 ha sera diellore ngelin pa rrugë, sepse gardhi i ri i vendosur nga projekti e pret këtë rrugë. Zgjidhja e vetme do të ishte që këto toka të lidheshin me një Urë mbi lumin lapardhica që lidh Lapardhanë me Moravën, dhe do të bënte të mundur kalimin e fermerëve në tokat e tyre. Ura do te jetë e pozicionuar mbi lumë, dhe do të përbëhet nga shpatulla anësore me hapësirë drite 20 m. Preventivi i hartuar për Objektin:“ Ndertimi i shpatullave te ures ne Lapardha Bashkia Berat” eshte 9 365 037.72 leke me tvsh. Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve ka hartuar projekt preventivin per: “Ndërtim i shpatullave te Ures në Lapardha” , në Njësinë Administrative Otllak .

Në mbështetje të ligjit nr 45/2019 “ Për mbrojtjen civile” dhe të VKM nr 414 datë 08.07.2021 “ Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” pika 3.1 gërma b, pika 5 , shkresës së Ministrisë së Mrojtjes nr 86/6 prot datë 27.03.2023” Mbi akordimin e fondeve të kushtëzuara për vitin 2023” ku Bashkisë Berat i është akorduar fondi në shumën 12,669,893.43 lekë, ju sjellim propozimet tona për të përdorur fondin e mbetur të akorduar nga buxheti i shtetit për mbrojtjen civile në shumën 4,298,156.00 dhe pjesën tjetër ne shumen 5,066,881,72 nga Buxheti i Bashkisë.

Këto ndërhyrje shërbejnë për marrjen e masave parandaluese, lehtësuse , mbrojtëse dhe rehabilituese në objektet infrastrukturore që përbëjnë një kërcënim serioz për jetën e njerëzve, pronave të tyre dhe mjedisin, të cilat ndikojnë në rikthimin e jetës normale për komunitetin dhe veprimtaritë e tij ekonomike , në përputhje me pikën 3.1 gërma b të VKM-së.

Bashkangjitur projekti me objekt " Ndertimi I shpatullave të Ureës së Lapardhasë "

Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Transportit, Pronave dhe Shërbimeve

Erlin Kuçi

Drejtoria e Planifikimit Urban , Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve

Luçiano Bojaxhiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

RELACION

PËR MIRATIMIN E STUDIMIT DHE FONDIT PËR SHËRBIMET SHTESË TË PASTRIMIT DHE TRANSFERIMIN E TYRE NË SHA ''BERAT CITY GREEN'' SHOQËRI AKSIONARE ME 100% TË AKSIONEVE TË BASHKISË BERAT

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkia Berat ka përgatitur Studimin për shërbimet shtesë të pastrimit të cilat përfshijnë shërbime që nuk janë parashikuar në kontratë aktuale me kompaninë sipërmarrëse për shërbimet e pastrimit në qytet.

Studimi përfshin shërbimet shtese të pastrimit në lagjet muzeale dhe shtratin e lumit,mirëmbajtjen e vend-depozitimit dhe riciklimin e mbetjeve urbane në qytetin e Beratit.

1-Shërbime pastrimi në lagjet muzeale.

Studimi për përcaktimin e kostos vjetore për shërbimin e mirëmbajtes dhe pastrimit të rrugicave në lagjet muzeale Mangalem, Goricë, Kala dhe Shtratin e Lumit është punuar duke marrë në konsideratë përgjegjësin për krijimin e kushteve më të mira dhe plotësimin me bazë materiale të domosdoshme për rritjen e shërbimit. Forma e dhënies së shërbimit të mirëmbajtjes në zonat muzeale nëpërmjet Bashkisë Berat është më efiçente dhe më cilësore. Për shkak të mungesës së kryerjes së shërbimit në këto zona në kontratën aktuale të pastrimit me nr. Prot 2241, dt. 25.04.2019, ky shërbim i ri do të përfshijë gjithë territorin e sipërcituar nga ku do të ofrojë shërbime shtesë.

Gjithashtu që nga viti 2019 që ka filluar kontrata e Shërbimit të Pastrimit është shfaqur si problematik nevoja për për zgjerime të sipërfaqeve të mirëmbajtjës dhe pastrimit në zonat muzeale, realizimi i të cilit ka qënë një domosdoshmëri duke shkaktuar probleme me menaxhimin e mbetjeve. Studimi i kryer është realizuar duke marrë parasysh përditësimet ligjore për kostot dhe pagat.

Me rritjen e fluksit turistik, Bashkia Berat numëron në periudhën Janar- Nentor 2023 rreth 750,000 turistë, dyfishi i numrit të turistëve krahasuar më të njëjtën periudhë të vitit 2022. Ky

fluks turistik bën të domosdoshëm shtrirjen e shërbimeve të pastrimit në lagjet muzeale dhe zonën e mbrojtur, duke përmirësuar ndjeshëm imazhin e qytetit.

2.Shërbimet për Venddepozitimin:

Nisur nga investimi i rehabilitimit të sheshdepozitimit të mbetjeve urbane të Bashkisë Berat i cili u realizuar me mbështetjen e Qeverisë së Zvicrës nëpërmjet SECO kërkohet mirëmbajtje e vazhdueshme e venddepozitimit në proçeset e punës që aty realizohen, proçese të cilat nuk janë të përfshira në kontratën aktuale (të sipër përmendur).

3. Shërbimet për Riciklimin e mbetjeve urbane

Bashkia Berat me mbështetjen e Ambasadës Suedeze, nëpërmjet Agjensisë Suedeze për Zhvillim SIDA, është përfituese e Projektit '' Ndarja e mbetjeve në burim në qytetin e Beratit''.

Projekti zbatohet në përputhje me VKM Nr. *418*, datë 25 Qershor 2017 "Për Ndarjen e mbetjeve në burim", synon të përcaktojë masat për ndarjen e mbetjeve në burim dhe grumbullimin e diferencuar, për uljen e sasisë totale të mbetjeve të dërguara për trajtim përfundimtar.

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është t'i ofrojë qytetit të Beratit skemën të ndarjes së mbetjeve shtëpiake në burim dhe përmirësimin e standardeve mjedisore dhe praktikave të menaxhimit të mbetjeve në bashkinë Berat.

Ky projekt përmes grumbullimit të ndarë në burim të mbetjeve të ricklueshme synon të lehtësojë rritjen e sasive dhe cilësisë së materialeve të ricikluara dhe të rikuperuara nga mbetjet shtëpiake.

Vitin e parë të shërbimit , riciklimi do ofrohet si shërbim me staf të reduktuar, për t'u plotësuar më pas, duke u bazuar në të ardhurat që do gjenerojë si shërbim.

Kostoja e shërbimeve shtesë për 3 shërbimet më sipër është parashikuar sipas studimit në vlerën **20,202,625 lekë me TVSH.**

Bashkia Berat këto fonde në shumën **20,202,625** lekë do t'ia kalojë SHA '' Berat City Green'' , shoqëri me kapitale 100% të Bashkisë Berat, për të menaxhuar shërbimet shtesë të pastrimit sipas tre komponentëve më sipër dhe bazuar në Studimin e përgatitur nga grupi i Punës i Bashkisë Berat.

Ju faleminderit,

KRYETARI I BASHKISË

Ervin DEMO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE TRANSPORTIT PRONAVE DHE SHERBIMEVE

R E L A C I O N

"PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË BERAT, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO - LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJET BANESAT E TË CILËVE JANE DËMTUAR NGA ZJARRI, NGA BUXHETI I BASHKISE I VITIT 2023, PROGRAMI " EMERGJENCAT CIVILE"

Të nderuar këshilltarë,

Në datën 28.08.2023 nga zjarri i renë u demtua banesa e ndodhur në Fshatin Osmenzeze, Njësia Administrative Sinjë ,Bashkia Berat .
Pas arkivimit të kërkesës së shtetasit Mikail Cuka (nipi i Bilbil Baza) dt.31.08.2023, Komisioni i Emergjencave i ngritur me Urdhërin Nr.561 datë 14.09.2023 të Kryetarit të Bashkisë , shkoi ne vendngjarje dhe në bazë të konstatimit fizik, hartoi proces verbalin e dëmeve të shkaktuara, mbështetur në VKM Nr.329, date 16.05.2012 "Per kriteret per procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore"
Proces verbali i konstatimit u percollë në Këshillin e Qarkut me shkresën Nr.4648 Prot, datë 18.09.2023 për vlerësimin e dëmeve sipas ligjit.
Komisioni i Ekspertëve të Këshillit të Qarkut,ka përfunduar vlerësimin e dëmeve të shkaktuara banesën e Z. Bilbil Bazaj dhe eshtë përcjellë në Bashkinë Berat me Nr. 839/1 Prot, date 01.11.2023. . Në mbështetje të preventivave të hartuara nga grupi i eksperteve dërguar në Bashkinë Berat rezultojnë dëmet :

1. Ne banesën e shtetasit Bilbil Bazaj vlerën 791 385 lek .
- Punime ndërtimore në vlerën 533 385 lek
- Orendi dhe pajisje 258 000 lek

Bazuar në dokumentacionin që disponojmë , në VKM Nr.329 datë 16.05.2012 shkronjen " ç", të pikës 1, të kreut III; i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë vlerën e ndihmës së menjëherëshme financiare për:
Z. Bilbil Bazaj në vlerën **395692** lek

Ndihma financiare do të përballohet nga fondet e emergjencës së Bashkisë për sigurimin e jetës dhe kushteve të përkoheshme të jetesës , si dhe për shpenzime të tjera për përballimin e situatës emergjente .

DREJTORI MCTPSH
Erlin Kuçi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

R E L A C I O N

PËR
HEQJEN E PËRKOHSHME TË DEPOZITAVE TË UJIT NGA PALLATET E BANIMIT DHE HEQJEN E MENJËHERSHME NGA OBJEKTET E DËMTUARA QË PARAQESIN RREZIK PËR JETËN DHE SHËNDETIN E NJERËZVE

Bashkia Berat me qëllim ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave që i ngarkon legjislacioni në fuqi, për realizimin e shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë propozon heqjen e përkohshme të depozitave të ujit nga pallatet e banimit dhe heqjen e menjëhershme nga objektet e dëmtuara që paraqesin rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve.

Tërmeti i fuqishëm i rënë në datën 26.11.2019, që tronditi Shqipërinë, përfshiu edhe territorin administrativ të Bashkisë së Beratit, ku janë evidentuar dëme të shumta ndërtimore në të gjitha Njësitë Administrative në juridiksionin e saj administrativ. Neni 29, pika 3, e ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ka përcaktuar si një nga funksionet dhe përgjegjësitë kryesore të njësive të vetëqeverisjes vendore në fushën e sigurisë publike garantimin e mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, si dhe parandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në komunitet.

Nëpërmjet këtij projektvendimi, Bashkia Berat propozon e hartimin e një akti standart për heqjen e depozitave të ujit nga tarracat. Sipas parashikimeve të këtij projektakti, propozojmë marrjen e masave të menjëhershme për heqjen e depozitave të ujit nga tarracat e pallateve që nga akt konstatimet paraprake të Institutit të Ndërtimit apo grupet përkatëse të inspektimit, janë shpallur të banueshme apo banorët e tyre janë evakuuar për shkak se godinat kërkojnë një rivlerësim të thelluar mbi gjendjen e tyre strukturore.

Kurse,

Sipas parashikimeve të këtij projektvendimit, propozojmë që të hiqen të gjitha depozitat e ujit nga tarracat, jo për t'i lënë pa alternativë, por që në bashkëpunim me administratorët e pallateve të kenë mundësi si pallatet e reja, në hapësirën e përbashkët në katin e parë ose në një nga vendet e parkimit, të kenë mundësi të instalojnë një depozitë të përbashkët të të gjithë

banorëve jo secili të vetën, që rrezikon kryesisht vatëm ata që janë katet e fundit, që janë të parët të prekur nga tarraca.

Bashkia Berat do të lejojë që depozitat në tarracë vetëm nëse inxhinierë konstruktorë të licencuar i japin aprovim administratorit të pallatit se tarraca .

Nisur nga rënia e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, e cila krijoi një situatë të papritur me pasoja të rënda për banorët e Bashkisë Berat, duke cënuar sigurinë e tyre dhe shkaktuar dëme të mëdha për jetën e njerëzve, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë", të ndryshuar, në të cilin është sanksionuar fakti se për përballimin dhe lehtësimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë. Sipas këtij vendimi, institucionet publike janë të detyruara të marrin masa të jashtëzakonshme për përballimin e kësaj situate. Konkretisht, referuar pikës 7.1, shkronjat "a" dhe "d" institucionet publike duhet të realizojnë plane masash organizative dhe administrative për përballimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe ndihmojnë në përballimin dhe lehtësimin e saj.

Duke shpresuar në miratimin e këtij projekt vendimi nga ana juaj,

Pergatiti Drejtori Z._____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

RELACION

MBI MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE TË MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË PËR MBULIM TVSH TË PROJEKTEVE TË BASHKISË BERAT ME FINANCIM TË HUAJ.
(shtesë buxheti me fondin për shpenzime kapitale për pagesë TVSH)

Të nderuar Këshilltarë ,

Bashkia Berat, në zbatim të ligjit Nr.84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023" ,të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 2 datë 19.01.2023 " Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023", ka kërkuar mbështetje me fonde për bashkëfinancimet dhe mbulimin e kostos së TVSH për projektet e ndihmës suaj pranë Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës në Kryeministri (SASPAC).

Agjensia SASPAC dhe Ministria e Financës dhe Ekonomisë ka miratuar kërkesën e Bashkisë Berat për mbulimin e TVSH për buxhetet e projektet e huaja si vijon:

1-Fond për pagesën e TVSH për projektin " Culture Lands " ,Programi 8220 "Trashegimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore", Kodi i produktit 90005AD, Shuma 117,894 Lekë.

Projekti '' Culture Lands '' financohet nga Komisioni Europian Fondet IPA Shqiperi Greqi me kontributin 15% të bashkëfinancimit të Bashkisë Berat .

2-Fond për pagesën TVSH për projektin ''Shërbime multifunksionale në sektorin e arsimit'' Programi 9120 "Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor" ,Kodi i produktit 09120 , shuma G102009 Lekë.

Projekti më sipër ka realizuar ndërhyrje rehabilituese në ish-godinën e SHIK, për t'a kthyer në një Qendër për Shërbimet Arsimore të Bashkisë Berat, rehabilitim të pjesshëm të kopshtit Moravë dhe Shkollës së Mesme Dyshnik, dhe disa aktivitete të lidhura me shërbimet më sipër, si blerje mjetesh didaktike për kopshtet dhe aktivitete vizibiliteti. Projekti financohet nga Programi BE për Bashkitë i Komisionit Europian dhe bashkëfinancim të Bashkisë Berat.

3- Fond për pagesën TVSH për projektin ''Shërbime multifunksionale në sektorin e arsimit'' Programi 9120 "Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor", Kodi i produktit 09120 , shuma G102009 Lekë.

Fondet që do përdoren nga granti i ardhur nga MFE janë me destinacion të përcaktuar si më sipër. Bashkia Berat në këtë mënyrë kursen nga buxheti i saj fondet në shumën 1,839,947 lekë,të cilat ishin parashikuar për mbulim TVSH për vitin 2023 për projektet më sipër.

Kërkojmë miratimin nga ana juaj të përdorimit të fondeve të MFE për projektet më sipër.

Faleminderit,

DREJTORE E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE PROJEKTEVE
Etleva Dhima

DREJTORE E FINANCË BUXHETIT
Rovena Shehu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____2023

MBI MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË PËR TRE FAMILJET BANESAT E PASHPRONËSUARA QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT " PËR KTHIMIN E BAZËS AJRORE KUÇOVË , NË BAZË AJRORE TAKTIKE TË NATOS " FSHATI MORAVË

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, neni 9, pika 1.1 , neni 24, neni 54, neni 64 gërma "c"; pika 34,45 e nenit 2, neni 33, 34 të ligjit nr.22/2018, "Për strehimin social", pikën 6 të VKM nr.459, datë 3.07.2019, "Mbi rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin" , VKM-në nr.753, date 09.12.2021 "Për shpronësimin ,për interesin publik,të pronarëve të pasurive të paluajtshme ,pronë private që preken nga realizimi i projekteve për kthimin e Bazës Ajrore Kuçovë , në Bazë Ajrore Taktike të NATO-s

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës për 3(tre) familjet banesat e pashpronësuara që preken nga zbatimi i projektit " Për kthimin e bazës Ajrore Kuçovë , në Bazë Ajrore Taktike të Natos " fshati Moravë, që përfitojnë bonus qiraje për vitin 2023, sipas tabelës bashkëlidhur këtij projekvendimi .

2. Vlera e bonusit të qirasë do të mbulohet nga buxheti i shtetit dhe do të filloj për çdo familje sipas afatit të kontratës së qirase .

3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi , ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit Financiare dhe e të Ardhurave , si dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile , Pronave,Transportit dhe Shërbimeve.

KRYETARI I KËSHILLIT

Ervin Ceca

Adresa:Blvd. "Republika ", Berat 5001.Shqipëri,Tel /00355(0) 2 32 34 935,Ëebsite: ëëë.bashkiaberat.gov.al, Email : bashkiaberat@yahoo.c

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E EMERGJENCAVE ,PRONAVE DHE TRANSPORTIT

R E L A C I O N

MBI MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË PËR TRE FAMILJET BANESAT E PASHPRONËSUARA QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT " PËR KTHIMIN E BAZËS AJRORE KUÇOVË , NË BAZË AJRORE TAKTIKE TË NATOS " FSHATI MORAVË

Të nderuar Këshilltare !

Në kuadër të mbështetjes dhe zbatimit të politikave të strehimit që Bashkia Berat ofron në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të pikës 34,45 nenit 2, neni 33,34 të ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social ", vkm nr.459,datë 3.07.2019 "Mbi rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin", për qytetarët në nevojë për t'u strehuar .

Nga realizimi i projektit për kthimin e Bazës Ajrore Kuçovë , në Bazë Ajrore Taktike të Natos " , bazuar në ligjin nr.8561 date 22.12.1999 "Për shpronësimet publike dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë ,pronë private , për interes publik" i ndryshuar dhe VKM-në nr.753, date 09.12.2021 që nuk janë shpronësuar kater banesa të ndodhura në fshatin Morave Njësia Administrative Otllak , të cilat kishin aplikuar për legalizim të banesave pranë ASHK Berat po që janë s'kualifikuar , konkretisht :

1.Banesa e Dervish Ruçaj s'kualifikuar nga ASHK Vendore Berat me Vendimin nr.451/1,datë 28.04.2022 " Për moslegalizimin e ndërtimit pa leje".

2.Banesa e Festim Akullit dhe Ardian Akullit s'kualifikuar nga ASHK Vendore Berat me Vendimin nr.16/1,datë 16.03.2023 " Për moslegalizimin e ndërtimit pa leje".

3.Banesa e Albert Meçaj s'kualifikuar nga ASHK Vendore Berat me Vendimin nr.17,datë 20.01.2023 " Për moslegalizimin e ndërtimit pa leje".

4.Banesa e Bajram Rakipit s'kualifikuar nga ASHK Vendore Berat me Vendimin nr.450/1,datë 28.04.2022 " Për moslegalizimin e ndërtimit pa leje".

Nga sa më sipër po ju sjellim për miratim bonusin e qirasë për tre familje , të cilat kanë dorëzuar kontrata e qirasë së banesës, pasi ish-bashkëshortja e Albert Meçaj Valentina Plaku me tre vajzat është strehuar në apartamentin e banesave sociale me strukturë 1 dhomë e 1 kuzhinë .

Bashkëlidhur tabela e listës së familjeve përfituese dhe e llogaritjes së bonusit të qirasë sipas formatit të kërkuar nga ministria përgjegjëse për strehimin.

Drejtore

Erlin Kuçi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
K R Y E T A R I

Nr._____prot. Berat , më___.___. 2023

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Z. Ervin Ceca
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK BERAT

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë projektvendimin dhe relacionin shoqërues " Mbi miratimin e bonusit të qirasë për tre familjet, banesat e pashpronësuara që preken nga zbatimi i projektit ,për kthimin e Bazës Ajrore Kuçovë , në bazë Ajrore Taktike të Natos " fshati Moravë .

K R Y E T A R I
Ervin DEMO

Miratoi:

Petro Sinjari: Drejtor i Drejtorisë Juridike

Rovena Shehu : Drejtoria e Menaxhimit Financiare dhe të Ardhurave

Erlin Kuçi : Drejtor i Mbrojtjes Civile ,Pronave Transportit dhe Shërbimeve

Konceptoi:
Meleqe Spahiu, Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit

Datë: _____

Nr. i faqeve A4 të projektvendimit: 1

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 1

Material Informues mbi Misionin e Komisionit të Integrimit Evropian:

Komisioni I Integrimit Europian ka qëllim:

1.Të mbështesë dhe koordinojë strukturat e bashkisë, në realizimin e reformave për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga proçesi i anëtarsimit në BE. Të monitoroj programimin dhe zbatimin me efiçencë të gjithë financimeve në kuadër të programeve të BE-së dhe donatorëve të tjerë,nga të cilat përfiton bashkia.

2. Komisioni merr në shqyrtim raportin e vlerësimit të përformancës së bashkive në procesin e integrimit evropian cili hartohet dhe raportohet cdo vit kalendarik.

3. Këshilltarët janë pjesë e aktiviteteve që Kryetari i Bashkise me mbështetjen e struktures së Integrimit Europian organizojnë në Bashki, në bashkepunim me strukturat e qeverisë qëndrore, Delegacionin e BE në Tiranë si dhe përfaqësitë e vendeve anëtare të BE-se.

4. Këshilltarët njihen me ecurinë e projekteve të financuara nga fondet e BE-se, të cilat janë pjesë e projekteve të bashkisë dhe donatorëve të tjerë, nëpërmjet raporteve të përgatitura 2 herë në vit nga administrata e bashkisë.

5. Këshilltarët mund të kërkojnë një seancë konsultimi më të gjithë aktorët lokalë dhe Kryetarin e Bashkisë për të diskutuar rezultat mbi performancën e bashkisë bazuar në vlerësimin vjetor të performancës së bashkive në procesin e integrimit evropian, si dhe masat që duhet të ndërrmerren për ato aspekte të vlerësimit ku Bashkia duhet të përformoj më mirë.

Adelina Farrici

Executive Director | Association of Local Autonomy of Albania (ALAA)

Sec. of the Albanian Delegation to the Congress of Local and Regional Authorities of the CoE

BASHKIA BERAT

PREVENTIV PUNIMESH

Objekti: Ndertimi I shpatullave te Ures se Lapardhas.

Nr.	Analize	Emertim Punimesh	Njesi	Sasi	Çmimi	Vlera
1	2.30	Germim themele e plinta b>2m, ekskavator me zinxhir 0.5m3,shkarkimi ne auto	m3	848.5		-
2	An SD1	Shpim me sonda Ø 0.8 m, ~ 15 m, pilota strukture	m	120		-
3	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25	m3	72		-
4	3.248	Struktura monolite betoni me çakell C 30/37	m3	186		-
5	3.289	F V hekur betoni periodik, Ç - 5, Ø > 12mm	ton	32.3		-
6	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri	m2	97		-
7	3.212/d	Shtrese stabilizant t=20cm	m2	97		-
		Shuma	**leke**			-
		T.V.SH.	**leke**			-
		Shuma me	**leke**			-

Punoi
Ark.Luciano Bojaxhiu
Ark.Iris Hoxhallari
Ing.Erida Nasufi
Top.Dejni Zylyftari

Miratoi
Kryetari I Bashkise
Ervin Demo

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA BERAT

BASHKIA BERAT

GRAFIK PUNIMESH

Objekti: Ndertimi I shpatullave te Ures se Lapardhas.

					Ndare ne dite		
Nr.	**Analize**	**Emertim Punimesh**	**Njesi**	**Sasi**	**10**	**10**	**10**
	2.30	Germim themele e plinta b>2m, ekskavator me zinxhir 0.5m3,shkarkimi ne auto	m3	848.5			
	An SD1	Shpim me sonda Ø 0.8 m, ~ 15 m, pilota strukture	m	120			
	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25	m3	72			
	3.248	Struktura monolite betoni me çakell C 30/37	m3	186			
	3.289	F V hekur betoni periodik, Ç - 5, Ø > 12mm	ton	32.3			
	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri	m2	97			
	3.212/d	Shtrese stabilizant t=20cm	m2	97			

Punoi
Ark.Luciano Bojaxhiu
Ark.Iris Hoxhallari
Ing.Erida Nasufi
Top.Dejni Zylyftari

Miratoi
Kryetari I Bashkise
Ervin Demo

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA BERAT

BASHKIA BERAT

PREVENTIV PUNIMESH

Objekti: Ndertimi I shpatullave te Ures se Lapardhas.

Nr.	Analize	Emertim Punimesh	Njesi	Sasi	Çmimi	Vlera
1	2.30	Germim themele e plinta b>2m, ekskavator me zinxhir 0.5m3,shkarkimi ne auto	m3	848.5	150.00	127,275.00
2	An SD1	Shpim me sonda Ø 0.8 m, ~ 15 m, pilota strukture	m	120	3,972.00	476,640.00
3	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25	m3	72	11,399.00	820,728.00
4	3.248	Struktura monolite betoni me çakell C 30/37	m3	186	15,292.00	2,844,312.00
5	3.289	F V hekur betoni periodik, Ç - 5, Ø > 12mm	ton	32.3	104,357.00	3,370,731.10
6	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri	m2	97	904.00	87,688.00
7	3.212/d	Shtrese stabilizant t=20cm	m2	97	792.00	76,824.00
		Shuma	**leke**			**7,804,198.10**
		T.V.SH.	**leke**			**1,560,839.62**
		Shuma me	**leke**			**9,365,037.72**

Punoi
Ark.Luciano Bojaxhiu
Ark.Iris Hoxhallari
Ing.Erida Nasufi
Top.Dejni Zylyftari

Miratoi
Kryetari I Bashkise
Ervin Demo

REPUBLIKA SHQIPËRISË - BASHKIA BERAT

BASHKIA BERAT

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN , LEJEVE DHE MONITORIMIT TE INVESTIMEVE

RELACION TEKNIK

OBJEKTI:" NDERTIM I SHPATULLAVE TE URES LAPARDHA,BASHKIA BERAT"

Punoi: Ark.luciano Bojaxhiu
Ark.Iris Hoxhallari
Ing.Erida Nasufi
Top.Dejni Zylyftari

BERAT 2023

I NFORMACION I PERGJITHSHEM MBI PROJEKTIN

- **Titulli i Projektit: :" Ndertim i Shpatullave te Ures Lapardha , Bashkia Berat"**
- **Vendi:Berat, Shqiperi**
- **Klienti : Bashkia Berat**
- **Faza e Projektit: Projekt Zbatimi**

1.1 Informacion i pergjithshem

Shqiperia ndodhet ne Europen Juglindore dhe ka nje siperfaqe prej 28.748 km^2. Kufizohet me Malin e Zi dhe Kosoven ne veri, Ish Republiken Jugosllave te Maqedonise ne lindje, dhe Greqine ne jug. Shqiperia shtrihet ne bregdetin lindor te detit Adriatik.

Gjatesia e pergjithshme e kufirit te Shqiperise eshte 1.094 km. Kufijte tokesore, detare, liqenore dhe lumore jane perkatesisht: 657 km, 316 km, 73 km dhe 48 km. Vija bregdetare eshte 427 km e gjate: 273 km i perkasin bregdetit te Adriatikut dhe 154 km bregdetit te Jonit.

Bazuar ne te dhenat e Rregjistrimit te Popullsise ne vitin 2011, rezulton se popullsia e Shqiperise eshte 2,895,947 banore.

Terreni qe pershkruan Shqiperine eshte 70% terren malor dhe pjesa tjeter fushor, kodrinor e bregdetar. Rajonet bregdetare kane klime te bute, por me ne brendesi dhe ne veri, klima karakterizohet nga dimer i ftohte dhe vere me reshje te konsiderueshme.

Ne Shqiperi funksionojne disa modalitete te transportit si :

- **Transporti ajror civil nderkombetar**
- **Transporti hekurudhor**
- **Transporti detar**

Transporti me i rendesishem ne Shqiperi eshte Transporti Rrugor. Sipas Planit Strategjik te Transportit te hartuar ne 2011, Rrjeti Kombetar Rrugor ne Shqiperi eshte rreth 18.000 km i gjate, duke perfshire 3.600 km rruge kombetare, 10.500 km rruge nder-urbane, dhe pjesa tjeter prej 4.000 km eshte nen juridiksionin e enteve private, kompanive, etj.

Rrjeti kombetar rrugor perbehet nga:

1. **Rrjeti Rrugor Paresor,** i cili eshte rreth 1.198 km i gjate dhe ka 9 arterie kryesore qe perbejne rrjetin baze,
2. **Rrjeti Dytesor,** i cili eshte rreth 2.083 km i gjate.

1.2 Vendndodhja e Projektit

Berati është qytet me rreth 65.000 banorë dhe njëra nga dy bashkitë e Rrethit të Beratit që bën pjesë në Qarkun e Beratit. Trojet e Beratit, sipas arkeologëve kanë qenë të banuara nga njerëz të civilizuar që nga shekulli VII para erës sonë. Rrethi Berat është i perbere prej 2 bashki e 10 komuna.

Qyteti i Beratit është ngritur fillimisht si kështjellë, mbi kodrën shkëmbore me lartësi 187m mbi nivelin e detit, në krahun e djathtë të lumit Osum, para se ky të dalë në fushën e Myzeqesë, më e madhja e Shqipërisë. Rrethi i Beratit shtrihet në Krahinën Malore Qendrore e pjesërisht në Ultësirën Jugperëndimore të Shqipërisë, në koordinatat: gjerësi gjeografike: Veri 40 gradë 52'24"; Jug 40 gradë 29'30" (qyteti 40 gradë 41'06"); gjatësi gjeografike: Lindje 20 gradë 10'51"; Perëndim 19 gradë 44'30" (qyteti 19 gradë 56'40"). Rrethi mbulon një sipërfaqe prej 953,6 km katror (qyteti 1,6 km katror).

Rrethi i Beratit shtrihet kryesisht në një territor me reliev malor e kodrinor, me lartësi mesatare mbi nivelin e detit 455m (qyteti 58 m). Fushat shtrihen në krahun veri-perëndimor të rrethit, në luginën e Osumit, derisa ajo bashkohet me fushën e Myzeqesë. Në mjedisin natyror të Beratit dallohen: zona fushore e kodrinore e Beratit dhe e Kuçovës, mali i Tomorit (Lindje, 2417m) dhe ai i Shpiragut (Perëndim, 1218m) si edhe lugina e Osumit dhe e Tomoricës. Zona fushore dhe ajo kodrinore janë baza e zhvillimit të prodhimit bujqësor, ndërsa malet dhe luginat përfaqësojnë burime të mëdha pyjore, kullosore dhe hidrike, ende të pashfrytëzuara si potenciale të rëndësishme të zhvillimit ekonomik e mjedisor.

Berati u përket qyteteve të rrallë ku jeta fillon qysh në lashtësinë e thellë dhe vazhdon pa u ndërprerë deri më sot. Dy çekanë guri e datojnë fillimin e jetës në të para Periudhës së Bronzit (2600-1800 P. Kr.). Dëshmitë arkeologjike tregojnë se në shek. VII-VI P. Kr. Këtu është zhvilluar një vendbanim paraqytetar, me punishtet e tij të qeramikës dhe me një jetë shoqërore të diferencuar. Në kufijtë e legjendës dhe të historisë, ky vendbanim thuhet të ketë qenë Orestiada e lashtë, i quajtur kështu ngaqë aty banonin një fis i pellazgëve, orestët, i pari i të cilëve ishte Oresti, i biri i Agamemnonit. Qyteti i mirëfilltë u themelua më 313-310 P. Kr. si qytet-kështjellë i Dasaretisë, i quajtur Antipatrea nga mbreti Kassandër në kujtim të gjeneralit mëkëmbës të Lekës së Madh. Ky është emri i parë i qytetit. Pas pushtimit romak në shek. II P. Kr. ai u quajt prej tyre Albanorum Oppidum (Fortesa e Arbërve). Në shek. V, nën perandorinë Bizantine, u përforcua dhe e ndryshoi emrin në Βουλγερολις (qyteti bullgar, sllv. Belgrad) në shekullin e X[2].

Pas tronditjes që pësoi reputacioni i qytetit në vitin 1997, ka një rivendosje të imazhit të mirë, sidomos këto dy-tre vitet e fundit, kur janë shtuar ndjeshëm flukset e vizitorëve nga vendi, nga Kosova e të huaj. Vërehet një riaktivizim i traditave më të mira të qytetit kundrejt vizitorëve. Tradicionalisht në Berat vizitori ka gjetur mikpritje të veçantë, përjetimin e një ambienti të këndshëm e shlodhës, rastin që të shijojë një kuzhinë karakteristike tradicionale të kombinuar me atë moderne, ku përfshihen ullinjtë e famshëm, mishi i qengjit dhe ai i gjelit të detit dhe verërat e prodhuara nga vreshtat rreth qytetit.

Degë më e zhvilluar e turizmit deri më tani ka qenë punime të artizanatit. Artizanati, për qytetin është një vlerë e trashëguar e cila mirëmbahet edhe sot në Berat në disa gjini, si: gdhendje ne dru qendistari, punime ne argjend dhe ne metale te tjera, punime ne kashte, gdhendje ne pllaka guri, punime dekorative me gur.

Vitet e fundit ka një rigjallërim të ketyre mjeshtërive. Vizitori mund të gjejë në disa dyqane gdhendje me pamje karakteristike të Beratit. Punimet e disa prej mjeshtrave të Beratit janë shpërndarë edhe jashtë vendit.[3] Në vitin 1901, Berati ishte qendër sanxhaku e varur nga vilajeti i Janinës.[4]

Turizmi është një ndër drejtimet më premtuese të zhvillimit ekonomik të Beratit. Qyteti trashëgon nga e kaluara një varg të gjatë e të pasur vlerash historike, kulturore, etnografike, arkitektonike e të besimeve, të tilla që përbëjnë një potencial të konsiderueshëm për turizmin. Me burimet turistike të qytetit është e mundur që të zhvillohet turizmi familiar dhe ai i organizuar. Në disa zona të rrethit (Tomor) mund të zhvillohet turizmi malor me shumë aspekte brenda tij, si edhe gjuetia.



Figura 1 – Pamje e Qytetit



Figura 2 – Horografia e URES

1.3 Objektivat e Studimit

Qellimi i ketij Projekt Zbatimi eshte ndertimi i nje ure per te lidhur dy fshatrat Lapardha dhe Morave ne tokat bujqesore pasi aktualisht nuk eshte i mundur aksesi me qellimin kryesor rritjen e aksesit per keta banore per kalimin ne tokat bujqesore .

2 IDENTIFIKIMI I PROJEKTIT

2.1 Vizita e detajuar ne terren

Gjate Implementimit te Projektit " Ndertim i Shpatullave te Ures Lapardha , BERAT" jane kryer vizita te detajuara ne terren pergjate terrenit ne te cilen do te ndertohet.

Figura 3 – Planvendosja e ures

Figura 4 –Foto ekzistuese nga vizita ne terren







3 PROJEKTIMI I STRUKTURAVE

Nje raport i vecante eshte pregatitur per persa i perket projektimit te strukturave.

Ura eshte e pozicionuar mbi lume, . Kjo ure eshte e perbere nga shpatullat anesore me hapesire drite 20 m. Planimetria dhe profili gjatesor i Ures eshte e treguar si ne figuren e meposhtme.



Figura 5–Planimetria e Ures





Figura 7–Armimi i shpatullave te ures

BASHKIA BERAT

OBJEKTI: "NDERTIMI I SHPATULLAVE TE URES NE LAPARDHA"

MIRATOI:
KRYETARI I BASHKISË
ERVIN DEMO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Planimetria e Shpatullave (2 cope) te ures



Pamja Ballore e Shpatullave (2 cope) te ures



Pamja Anesore e Shpatullave (2 cope) te ures



BETONET
Betoni që përdoret për elementët
solete e trare të jetë i klasës C^{25}_{30}
me këto karakteristika:
Rezistencë Kubike - R/ck =250 kg/cm²
Koeficient Sigurie - γ/c =1.5
Zgjatimi Relativ - ε/cu = 0.35%
Madhësia maksimale e agregatit prej 20 mm.
Betoni përpara që të vendoset në vepër duhet
të kontrollohet nëse i plotëson kërkesat e nevojshme.

ARMATURA ÇELIKUT
Armatura që përdoret për elementët solete e traret
të jetë çelik të klasës B500b me këto karakteristika:
Rezistenca karakteristike të rrjedhshmërisë - f/yk = 5000 kg/cm²
Rezistenca karakteristike të këputjes - f/us = 6000 kg/cm²
Koeficient Sigurie - γ/s =1.15
Zgjatimi Relativ - ε/cu ≥ 10%, (me duktilitet të mesëm)
E gjithë armatura e çelikut dhe vendosja e tij në vepër duhet
të jetë sipas Euronormet EN10080.
Çeliku përpara që të vendoset në vepër të pastrohet nga
papastërtitë dhe nga ndryshku.
Për më shumë referojuni EN1992-1-1, EN10080.

00		Projekt Zbatimi	
RISH NR.	DATA	QËLLIMI I DOREZIMIT	SHËNIM / PËRSHKRIM

BASHKIA BERAT

KONSULENTI INXHINIERIK

Nr. Licencës: -

	Pozicioni	Emri	Nr. Licencës	Firma
Përgatiti	Ark	Luciano Bojaxhiu		
	Ark	Iris Hoxhallari		
	Ing	Erida Nasufi		
	Top	Dejni Zylyftari		
Miratoi				

TITULLI I PROJEKTIT

"URA - LAPARDHA"

EMRI I DOKUMENTIT

SHPATULLAT E URES

FAZA E PROJEKTIT	Nr. i Dokumentit	Shkalla	Rishikimi	Përmasa e fletës	Fleta
PROJEKT ZBATIMI		1:50			

Armimi i Shpatullave te ures



Prerja 1-1



Prerja 2-2



PRERJA 4-4
ARMIMI I SEKSIONIT TËRTHORË TE PILOTES

SHËNIM:
Shtresa mbrojtëse jo më pak se c=5cm.

Prerja 3-3



BETONET
Betoni që përdoret për elementët solete e trare të jetë i klasës C^{25}_{30} me këto karakteristika:
Rezistencë Kubike - R/ck =250 kg/cm²
Koeficient Sigurie - γ/c =1.5
Zgjatimi Relativ - ε/cu = 0.35%
Madhësia maksimale e agregatit prej 20 mm.
Betoni përpara që të vendoset në vepër duhet të kontrollohet nëse i plotëson kërkesat e nevojshme.

ARMATURA ÇELIKUT
Armatura që përdoret për elementët solete e traret të jetë çelik të klasës B500b me këto karakteristika:
Rezistenca karakteristike të rrjedhshmërisë - f/yk = 5000 kg/cm²
Rezistenca karakteristike të këputjes - f/us = 6000 kg/cm²
Koeficient Sigurie - γ/s =1.15
Zgjatimi Relativ - ε/cu ≥ 10%, (me duktilitet të mesëm)
E gjithë armatura e çelikut dhe vendosja e tij në vepër duhet të jetë sipas Euronormet EN10080.
Çeliku përpara që të vendoset në vepër të pastrohet nga papastërtitë dhe nga ndryshku.
Për më shumë referojuni EN1992-1-1, EN10080.

00		Projekt Zbatimi	
RISH NR	DATA	QËLLIMI I DOREZIMIT	SHËNIM / PËRSHKRIM

BASHKIA BERAT

KONSULENTI INXHINIERIK
Nr. Licencës: -

	Pozicioni	Emri	Nr. Licencës	Firma
Përgatit	Ark	Luciano Bojaxhiu		
	Ark	Iris Hoxhallari		
	Ing	Erida Nasufi		
	Top	Dejni Zyllyfiari		
Miratoi				

TITULLI I PROJEKTIT
"URA - LAPARDHA"

EMRI I DOKUMENTIT
ARMIMI I SHPATULLAVE TE URES

FAZA E PROJEKTIT	Nr. i Dokumentit	Shkalla	Rishikimi	Përmasa e fletës	Fleta
PROJEKT ZBATIMI		1:50			

PLANIMETRIA E URES



00		Projekt Zbatimi	
RISH. NR.	DATA	QELLIMI I DOREZIMIT	SHENIM / PERSHKRIM

BASHKIA BERAT

KONSULENTI INXHINIERIK

Nr. Licencës: -

	Pozicioni	Emri	Nr. Licencës	Firma
Përgatiti	Ark	Luciano Bojaxhiu		
	Ark	Iris Hoxhallari		
	Ing	Erida Nasufi		
	Top	Dejni Zylyftari		
Miratoi				

TITULLI I PROJEKTIT

"URA - LAPARDHA"

EMRI I DOKUMENTIT

PLANIMETRIA E KOLLONAVE TE URES

FAZA E PROJEKTIT	Nr. i Dokumentit	Shkalla	Rishikimi	Përmasa e fletës	Fleta
PROJEKT ZBATIMI		1:80			

PLANIMETRIA E URES



00		Projekt Zbatimi	
RISH NR.	DATA	DËLLIMI I DOREZIMIT	SHËNIM / PËRSHKRIM

BASHKIA BERAT

KONSULENTI INXHINIERIK

Nr. Licencës: -

	Pozicioni	Emri	Nr. Licensës	Firma
Përgatit	Ark	Luciano Bojaxhiu		
	Ark	Iris Hoxhallari		
	Ing	Erida Nasufi		
	Top	Dejni Zylyftari		
Miratoi				

TITULLI I PROJEKTIT

"URA - LAPARDHA"

EMRI I DOKUMENTIT

PLANIMETRIA E URES

FAZA E PROJEKTIT	Nr. i Dokumentit	Shkalla	Rishikimi	Përmasa e fletës	Fleta
PROJEKT ZBATIMI		1:80			

PLANIMETRIA E URES



00		Projekt Zbatimi	
RISH NR	DATA	QËLLIMI I DOREZIMIT	SHËNIM / PËRSHKRIM

BASHKIA BERAT

KONSULENTI INXH-NIERIK

Nr. Licencës: -

	Pozicioni	Emri	Nr. Licencës	Firma
Përgatiti	Ark	Luciano Bojaxhiu		
	Ark	Iris Hoxhallari		
	Ing	Erida Nasufi		
	Top	Dejni Zylyftari		
Miratoi				

TITULLI I PROJEKTIT

"URA - LAPARDHA"

EMRI I DOKUMENTIT

PLANIMETRIA E URES

FAZA E PROJEKTIT	Nr. i Dokumentit	Shkalla	Rishikimi	Përmasa e fletës	Fleta
PROJEKT ZBATIMI		1:80			

PLANIMETRIA E URES



00		Projekt Zbatimi	
RISH. NR.	DATA	QËLLIMI I DORËZIMIT	SHËNIM / PËRSHKRIM

BASHKIA BERAT

KONSULENTI INXHINIERIK

Nr. Licencës: -

	Pozicioni	Emri	Nr. Licencës	Firma
Përgatiti	Ark	Luciano Bojaxhiu		
	Ark	Iris Hoxhallari		
	Ing	Erida Nasufi		
	Top	Dejni Zylyftari		
Miratoi				

TITULLI I PROJEKTIT

"URA - LAPARDHA"

EMRI I DOKUMENTIT

PLANIMETRIA E URES

FAZA E PROJEKTIT	Nr. i Dokumentit	Shkalla	Rishikimi	Përmasa e fletës	Fleta
PROJEKT ZBATIMI		1:80			

PLANIMETRIA E URES



00		Projekt Zbatimi	
RISH NR.	DATA	SHËLLIMI I DOREZIMIT	SHËNIM / PËRSHKRIM

BASHKIA BERAT

KONSULENTI INXHINIERIK

Nr. Licences -

	Pozicioni	Emri	Nr. Licenses	Firma
Përgatit	Ark	Luciano Bojaxhiu		
	Ark	Iris Hoxhallari		
	Ing	Erida Nasufi		
	Top	Dejni Zylyftari		
Miratoi				

TITULLI I PROJEKTIT

"URA - LAPARDHA"

EMRI I DOKUMENTIT

PLANIMETRIA E URES

FAZA E PROJEKTIT	Nr. i Dokumentit	Shkalla	Rishikimi	Përmasa e fletës	Fleta
PROJEKT ZBATIMI		1:80			

FOTOT E GJENDJES EKZISTUESE



FOTOT E GJENDJES EKZISTUESE





FOTOT E GJENDJES EKZISTUESE

AKSI



AKSI
Numeri Profilit : –9–
Progresivi : 0+040.00
Shkalla : 100:100
Kuota.Referuese : 32.50

| | | |



AKSI
Numeri Profilit : -10-
Progresivi : 0+041.64
Shkalla : 100:100
Kuota.Referuese : 32.50

| | | |



AKSI
Numeri Profilit : –11–
Progresivi : 0+044.42
Shkalla : 100:100
Kuota.Referuese : 32.50

| | | |



AKSI
Numeri Profilit : -5-
Progresivi : 0+020.00
Shkalla : 100:100
Kuota.Referuese : 32.50

| | | |



AKSI
Numeri Profilit : -6-
Progresivi : 0+025.00
Shkalla : 100:100
Kuota.Referuese : 32.50

| | | |



AKSI
Numeri Profilit : -7-
Progresivi : 0+030.00
Shkalla : 100:100
Kuota.Referuese : 32.50

| | | |



AKSI
Numeri Profilit : -1-
Progresivi : 0+007.11
Shkalla : 100:100
Kuota.Referuese : 32.50

| | | |



AKSI
Numeri Profilit : -2-
Progresivi : 0+011.17
Shkalla : 100:100
Kuota.Referuese : 32.50

| | | |



AKSI
Numeri Profilit : -3-
Progresivi : 0+012.99
Shkalla : 100:100
Kuota.Referuese : 32.50

| | | |





RISH. NR	DATA	QËLLIMI I DOREZIMIT	SHENIM / PËRSHKRIM
00		Projekt Zbatimi	

BASHKIA BERAT

KONSULENTI INXHINIERIK

Nr. Licencës: -

	Pozicioni	Emri	Nr. Licencës	Firma
Pergatiti	Ark	Luciano Bojaxhiu		
	Ark	Iris Hoxhallari		
	Ing	Erida Nasufi		
	Top	Dejvi Zylyftari		
Miratoi				

TITULLI I PROJEKTIT

"URA - LAPARDHA"

EMRI I DOKUMENTIT

PLANIMETRIA E URES

FAZA E PROJEKTIT	Nr. i Dokumentit	Shkalla	Rishikimi	Përmasa e fletës	Fleta
PROJEKT ZBATIMI		1:80			

BASHKIA BERAT

STUDIMI PER SHËRBIMET SHTESË TË PASTRIMIT NË QENDRËN HISTORIKE DHE SHTRATIN E LUMIT , VEND-DEPOZITIMIT DHE RICIKLIMIN E MBETJEVE URBANE NË QYTETIN E BERATIT

Përgatiti:

Grupi i Punës:

1- Luciano Bojaxhiu
2- Erlin Kuçi
3- Petro Sinjari
4- Etleva Dhima
5- Denada Gjogu
6- Melisa Nurellari
7- Dejni Zylyftari

MIRATOI

KRYETARI I BASHKISË

Ervin DEMO

1.1 Historiku Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta

Në vitin 2014, Shqipëria u shpall si një vend kandidat i BE. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (SAA), e nënshkruar më 2006, artikulon ambicjen e Shqipërisë për integrimin në BE dhe vendos objektivat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për qëndrueshmërinë mjedisore të vendit. Arritja e këtyre objektivave raportohet nëpërmjet serive të raporteve vjetore të BE për Shqipërinë. Në raportin për vitin 2018, mbetjet përmenden në kapitullin 27: Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike: Ka pasur disa arritje në përafrimin e politikave dhe legjislacionit sidomos nëpërmjet rishikimit të strategjisë kombëtare për menaxhimin e mbetjeveve. Raporti vazhdon të thotë se "nevojiten përpjekje të mëtejshme për:

- Mbylljen e mbi 300 venddepozitimeve të papërshtatshme,
- Rritjen e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në rryma të ndryshme të mbetjeve
- Reduktimit të mbetjve biologjike”

Zotimet e marra në kuadër të MSA janë të parashtruara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2014-2020 ose Draft Strategjinë Ndërsektoriale të Mjedisit (2015–2020). Versioni i draftit të hartuar (2019) i Strategjisë Shqiptare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Planit të Veprimit është përpunuar nën Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

1.2 Kuadri ligjor Kombëtar

Në tabelën në vijim jepen ligjet dhe aktet nënligjore shqiptare me rëndësi të veçantë për MMN bashkiake.

Table 1 Ligje dhe Akte nënligjore përkatëse për MMN bashkiake

Ligji Nr./Viti	Përmbajtja	Ndryshimet ligjore Nr./viti
68/2017	Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore	
139/2015	Për Vetëqeverisjen Vendore	
115/2014	Për Ndarjen Administrative-Territoriale Të Njësive Të Qeverisjes Vendore	
107/2014	Për Planifikimin Dhe Zhvillimin E Territorit	73/2015
125/2013	Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat	77/2015
10448/2011	Për lejet e Mjedisit	44/2013
10463/2011	Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve	156/2013 32/2013
10440/2011	Për Vleresimin e Ndikimit në Mjedis	
8094/1996	Për largimin Publik të Mbetjeve	
VKM Nr/Viti	**Përmbajtja**	**Ndryshimet VKM Nr./viti**
452/2012	Për lendfillet e mbetjeve	389/2018: Standartet per rehabilitimin dhe operimin e venddepozitimeve
319/2018	Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve	
608/2014	Për Përcaktimin e Masave të Nevojshme për Grumbullimin dheTrajtimin e Mbetjeve Bio	
418/2014	Për Grumbullimin e diferencuar të Mbetjeve në Burim	
957/2012	Për Mbetjet nga pajisjet Elektrike dhe Elektronike	
866/2012	Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre	
765/2012	Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura	
705/2012	Për Menaxhimin e Mbetjeve nga Automjetet ne vitet e fundit të jetës	
452/2012	Per lendfillet e mbetjeve	
178/2012	Përdjegien e mbetjeve	
177/2012	Për amballazhet dhe mbetjet e tyre	VKM Nr.232, date 26.4.2018
333/2011	Për Menaxhimin e venddepozitimeve Rajonale të Mbetjeve	
798/2010	Për miratimin e Rregullores për Menaxhimin Mbetjeve Spitalore	
99/2005	Për miratimin e Katalogut Shqiptar të Mbetjeve	

Një version draft i një ndryshimi të Ligjit Nr. 10463 për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve është aktualisht në konsultim. Draft-ndryshimi rishikon procedurën e miratimit dhe raportimit për planet rajonale dhe vendore të administrimit të mbetjeve. Sipas draftit, planet vendore të administrimit të mbetjeve do të hyjnë në fuqi pas miratimit nga këshilli bashkiak dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Nga bashkitë gjithashtu kërkohet që të raportojnë çdo vit drejtpërdrejt në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrinë e Energjitikes dhe Infrastrukturës.

Ligji nr. 139/2015 Për Vetëqeverisjen Vendore i përcakton bashkitë si nivel bazë të njësisë së vetëqeverisjes lokale, i cili përbëhet nga disa njësi administrative. Për më tepër, ligji rregullon të drejtën dhe përgjegjësinë e bashkive, ndër të tjera për krijimin dhe grumbullimin e të ardhurave, vendosjen e tarifave vendore për shërbimet dhe përcaktimin e tarifave të tyre, bashkëpunimin me NJQV të tjera. Ligji gjithashtu përcakton përgjegjësinë e bashkive në mbledhjen, asgjësimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.

Ligji për Financat Vendore (Ligji nr.68, datë 27.04.2017) paraqiti konceptin e mbulimit të shpenzimeve përmes tarifave. Bazuar në këtë ligj, niveli i tarifave është i orientuar drejt mbulimit të kostove të shërbimeve publike të ofruara nga NJQV. Qeverisja vendore mund të caktojë tarifa vetëm për shërbimet publike, konsumi ose përfitimi i të cilave, në parim, është i matshëm për përdoruesit ose përfituesit, duke përdorur instrumente të përshtatshme për të siguruar akses, cilësi, sasi dhe kosto të përballueshme nga të gjithë.

Ligji i ndryshuar nr. 125, datë 25.04.2013, Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat (Ligji nr.77, datë 16.07.2015), thotë se koncesionet dhe partneritetet publike-private (PPP) mund të jepen për kryerjen e punëve dhe ofrimin e shërbimeve për, ndër të tjera, menaxhimin e mbetjeve, duke përfshirë mbledhjen, trajtimin, transferimin dhe ruajtjen (Neni 4ç). Ky amendim tregon se bashkëpunimi ndërmjet sektorit publik dhe sektorit privat është pjesë e politikës së qeverisë për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve.

Ligji i ndryshuar nr. 107, datë 31.07.2014, Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit (Ligji nr.73, datë 09.07.2015), thotë se infrastruktura publike nënkupton tërësinë e rrjeteve, instalimeve dhe ndërtimeve ekzistuese ose të planifikuara në territor, si dhe hapësirat publike, duke synuar realizimin e shërbimeve publike në fushat e transportit, energjisë, menaxhimit të ujit, komunikimeve elektronike, arsimit, shëndetësisë, menaxhimit të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit, menaxhimin e burimeve natyrore dhe kulturore, mbrojtjen kombëtare, civile dhe të zjarrit dhe fusha të tjera të ngjashme duke i shërbyer publikut nfrastruktura publike ka karakter kombëtar ose vendor dhe kryhet me investime publike ose private (Neni 3.11.).

VKM Nr. 389, datë 27.6.2018, miraton ndryshime në VKM 452, datë 11.07.2012 "Për venddepozitimet". Në Aneksin e saj, VKM përcakton ndër të tjera standarde për rehabilitimin dhe funksionimin e venddepozitimeve. VKM nr. 319, datë 31.5.2018 ofron udhëzime për llogaritjen e kostoveve të MMN.

VKM nr. 418, datë 25.6.2014, përcakton objektivat e riciklimit për NJQV-të. Bashkitë duhet të marrin masat e duhura për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve së paku për letër / karton,

metal, plastikë dhe xham brenda 31.12.2016 për bashkite e kategorisë së parë (përfshirë Qytetin e Beratit) dhe 31.12.2018 për bashkitë e tjera.

Shifrat në vijim krahasojnë objektivat ligjore dhe të politikës dhe objektivat për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta të vendosura në ligjet kombëtare, VKM-të dhe Draft Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve si dhe në Direktivat e BE-së. Ndërsa objektivat dhe synimet e vendosura në VKM janë të vjetëruara, objektivat në Draft Strategjinë Kombëtare janë brenda afatit kohor aktual. Bazuar në këshillën e përfaqësuesit të Ministrisë së Mjedisit në grupin e punës, PVMMN është hartuar në përputhje me objektivat dhe shënjestrimet e përcaktuara në Draft Strategjinë Kombëtare e cila pritet të miratohet në Qershor 2019.

1.3 Profili i Bashkisë

Berati është një nga pesë bashkitë e Qarkut të Beratit. Ai ka një siperfaqe prej 380 km² dhe kufizohet me të katër komunat e Rajonit të Beratit si dhe Rajonin e Elbasanit në veri-lindje dhe Fier në jug-perendim. Qendra administrative e bashkisë dhe gjithashtu e qarkut në të njëjtën kohë, qyteti i Beratit është vendosur në bregun e djathtë të lumit Osum në tarracat e hapura në shpatet e maleve të Tomorrit. Pas reformës territorial dhe administrative në vitin 2015 (TAR), bashkia përbëhet tani ngaqyteti i Beratit, si dhe nga ish-komunat rurale fqinje. Së bashku ato formojnë pesë njësi administrative (AU) të bashkisë. Harta e mëposhtme tregon pozicionin gjeografik dhe ndarjen administrative të bashkisë.



Figure 1 Vështrim i përgjithshëm i Bashkisë Berat

Bashkia e Beratit ka numrin më të madh të popullsisë krahasuar me bashkitë e tjera në qark me një shifër prej rreth 99,787 banorë sipas të dhënave nga MFE. Rreth 60% e popullsisë jeton në

qytetin e Beratit, në zonën të bashkisë. Njësia e dytë më e populluar është Nj.A periferike e Otllakut. Pjesa tjetër e njësive administrative janë zonat rurale me karakteristikë bujqësore. Tabela në vijim paraqet njësitë administrative së bashku me numrin e popullsisë së vlerësuar, llojet e vendbanimeve dhe qytetet / fshatrat që ndodhen brenda kufijve të njësive administrative.

1.4 Qellimi i punës

Studimi për përcaktimin e kostos vjetore për shërbimin e mirëmbajtes dhe pastrimit të rrugicave në lagjet muzeale Mangalem, Goricë, Kala dhe Shtratin e Lumit është punuar duke marrë në konsideratë përgjegjësin për krijimin e kushteve më të mira dhe plotësimin me bazë materiale të domosdoshme për rritjen e shërbimit. Forma e dhënies së shërbimit të mirëmbajtjes në zonat muzeale nëpërmjet Bashkisë Berat është më efiçente dhe më cilësore. Për shkak të mungesës së kryerjes së shërbimit në këto zona në kontratën aktuale të pastrimit me nr. Prot 2241, dt. 25.04.2019 ”Menaxhim i integruar i mbetjeve te ngurta urbane të Bashkisë Berat 2019-2024” ky shërbim i ri do të përfshijë gjithë territorin e sipërcituar nga ku do të ofrojë shërbime shtesë. Gjithashtu që nga viti 2019 që ka filluar kontrata e Shërbimit të Pastrimit është shfaqur si problematik nevoja për për zgjerime të sipërfaqeve të mirëmbajtjës dhe pastrimit në zonat muzeale, realizimi i të cilit ka qënë një domosdoshmëri duke shkaktuar probleme me menaxhimin e mbetjeve. Gjithashtu studimi i kryer është realizuar duke marrë parasysh përditësimet ligjore për kostot dhe pagat. Nisur nga investimi i rehabilitimit të sheshdepozitimit të mbetjeve urbane të Bashkisë Berat i cili u realizuar me mbështetjen e Qeverisë së Zvicrës nëpërmjet SECO kërkohet mirëmbajtje e vazhdueshme e venddepozitimit në proçeset e punës që aty realizohen, proçese të cilat nuk janë të përfshira nëkontratën aktuale (të sipër përmendur).
Me rritjen e fluksit turistik, Bashkia Berat numëron në gjashtë muajt e parë të vitit 2023 rreth 400,000 turistë, pothuajse dyfishi i numrit të turistëve krahasuar më të njëjtën periudhë të vitit 2022. Ky fluks turistik bën të domosdoshëm shtrirjen e shërbimeve të pastrimit në lagjet muzeale dhe zonën e mbrojtur.

Riciklimi
Bashkia Berat me mbështetjen e Ambasadës Suedeze, nëpërmjet Agjensisë Suedeze për Zhvillim SIDA, është përfituese e Projektit ‘’ Ndarja e mbetjeve në burim në qytetin e Beratit’’.

Projekti zbatohet në përputhje me VKM Nr. *418*, datë 25 Qershor 2017 “Për Ndarjen e mbetjeve në burim”, synon të përcaktojë masat për ndarjen e mbetjeve në burim dhe grumbullimin e diferencuar, për uljen e sasisë totale të mbetjeve të dërguara për trajtim përfundimtar.

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është t’i ofrojë qytetit të Beratit skemën të ndarjes së mbetjeve shtëpiake në burim dhe përmirësimin e standardeve mjedisore dhe praktikave të menaxhimit të mbetjeve në bashkinë Berat.

Ky projekt përmes grumbullimit të ndarë në burim të mbetjeve të ricklueshme synon të lehtësojë rritjen e sasive dhe cilësisë së materialeve të ricikluara dhe të rikuperuara nga mbetjet

shtëpiake. Ndarja në burim zbatohet për veprimin e ndarjes së mbetjeve në momentin kur ato krijohen, në vend që të bëhet ndarja e tyre kur ato janë të përziera.

Një pjesë e këtij hapi kërkon që komponentët e ndarë më pas të mblidhen dhe transportohen në mënyrë që të reduktojë ose parandalojë ndotjen e mëvonshme. Ndarja në burim e rrymave të ndryshme të mbetjeve konsiderohet si një parakusht thelbësor për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm riciklimi me norma të larta riciklimi2. Grumbullimi i rrymave të përziera të mbetjeve bashkiake çon në kontaminim të kryqëzuar dhe humbje ose reduktim të vlerës së lëndëve të para dytësore.

Modeli i propozuar nga Grupi i Punës i Bashkisë, për qëllim të këtij projekti, propozon që zonat e shërbimit të riciklimit të jenë si më poshtë:

• **Zona 1:** Zona urbane me ndërtesa të larta e shërbyera me kontejnerë të veçantë 1.1 m3 për lëndët e ricikluesshme, të sistemuara në "pikat e grumbullimit të mbetjeve" dhe të grumbulluara me kamionë 8 m3. Frekuenca e grumbullimit do të ishte 3 herë në javë, e organizuar në dy itinerare të ndryshme. Në këto itinerare do të përfshihen edhe prodhuesit e mëdhenj, si bizneset dhe magazinat (të cilat do të pajisen me kontejnerë të vecantë);

• **Zona 2:** Vendbanimet Uznove dhe Kalaja (zona historike), do të shërbeheshin derë më derë duke përdorur kosha 240 l dhe grumbullohen me kamioni 3m3 ose 5 m3, dhe vendbanimi Gorice do të shërbehet derë më derë me qese plastike ose kosha 240 l nga i njëjti kamion.

• **Zona 3:** Zonë kodrinore, e shërbyer derë më derë me qese plastike dhe e mbledhur me karroca (karroca dore).

Studimi ka konsideruar si "zonë të vecantë" bizneset e mesme dhe të mëdha, veçanërisht ato që gjenerojnë sasi të moderuar mbetjesh të ricikluesshme, me kontejnerë të dedikuar, grumbullimi i të cilëve do të kryhet sipas itinerareve të përcaktuara.

Infrastruktura për ndarjen në burim dhe grumbullimin e diferencuar të mbetjeve do të përfshijë 2 automjete (kamionë) shtesë për grumbullimin e mbetjeve dhe një numër të llogaritur kontejnerësh prej 1.1 m3 , kosha plastike 240 l dhe një numër të caktuar qesesh plastike.

Kamionët do të kenë specifikimet si më poshtë:

- Automjete grumbulluese me **2 boshte me ngarkim** nga mbrapa, me kapacitet nga **8 m^3** me pajisje ngritjeje me pirun të ndarë në pjesën e pasme të aftë për të ngarkuar **kosha (240 l) dhe kontejnerë (1,1 m3)** në përputhje me standardet EN840-1 dhe EN 840-3.
- Automjete grumbulluese me **1 bosht me ngarkesë** nga mbrapa me kapacitet nga 3 m3 deri në 5 m3 me pajisje ngritjeje me pirun të ndarë në pjesën e pasme të aftë për të ngarkuar **kosha (240 l) (të ngjashëm me tip Piaggio - Porter Maxxi D120** ose marka të ngjashme)**.**

Objekte të tjera për shërbimin e grumbullimit dhe ndarjes së mbetjeve të ricikluesshme që janë parashikuar per zbatimin e metodologjisë janë:

- Ndërtimi dhe pajisja e një Impianti të Klasifikimit/Ndarjes të Mbetjeve dhe furnizimi dhe instalimi i një peshore – urë në territorin e venddepozitimit ekzistues (landfilli i bashkisë Berat); dhe,
- Rehabilitimi i pikave të grumbullimit të mbetjeve në anë të rrugës ose pikat e grumbullimit të mbetjeve

Strategjia dhe Plani i Komunikimit ka përcaktuar objektiva të qarta komunikimi ku mjetet e komunikimit mund të kontribuojnë efektivisht në arritjen e objektivave të përcaktuara.

Përsa i përket zhvillimit organizativ dhe masave të tjera mbështetëse për zbatimin e modelit të ndarjes së mbetjeve shtëpiake në burim në qytetin e Beratit, Projekti "Ndarja në Burim e Mbetjeve Shtëpiake në Berat" ,propozon që ndarja në burim, duke përfshirë nën-aktivitete të tjera si grumbullimi dhe transporti i diferencuar dhe para-trajtimi i të mbetjeve të riciklueshmeve mund të kryhet nga një Operator i Shërbimeve Publike.

Për këtë arsye, sipas studimit të kryer nga Grupi i Punës së Projektit, kërkohet ngritja e një strukture të posaçme per riciklimin, në përbërjen e të cilës do jenë si fillim 2 punonjës/shofer. Vitin e parë të shërbimit , riciklimi do ofrohet si shërbim me staf të reduktuar, për t'u plotësuar më pas, duke u bazuar në të ardhurat që do gjenerojë si shërbim.

Situata aktuale në vend

Aktualisht Bashkia Berat e kryen shërbimin e pastrimit nëpërmjet firmës kontraktuale "Ante Group"sh.p.k. në bazë të një kontrate me nr.Prot 2241, dt. 25.04.2019 "Menaxhim i integruar i mbetjeve te ngurta urbane të Bashkisë Berat 2019-2024".
Shërbimi i Pastrimit kryhet çdo ditë të javës në qytetin e Beratit, në Njësinë Administrative Otllak kryhet 4 herë/javë, dhe në Njësitë Administrative Sinjë, Velabisht, Roshnik dhe Fshatin Duhanas kryhet 2 herë/javë.
Mbetjet e grumbulluara nga firma e pastrimit "Ante Group' në qytetin e Beratit dhe në Njesitë Administrative depozitohen në venddepozitimin e mbetjeve urbane i cili ndodhet në Orizaj, Njësia administrative Otllak. Sasia totale e mbetjeve të depozituara është 16.088 ton/vit.
Në Bashkinë Berat gjatë periudhes shtator 2020 – Prill 2021 me mbështetjen e Qeverisë së Zvicrës nëpërmjet SECO është përfituar Projekti i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta i cili ka realizuar kapsulimin e mbetjeve ekzistuese, ndërtimin e impiantit të grumbullimit të gazit, ndërtimin e impiantit të grumbullimit të lëngut kullues dhe rrethimin e sheshdepozitimit. Zona e asgjësimit të mbetjeve është projektuar për një volum prej 135 600 m^3 mbetje për pesë vite.

ZËRAT E SHËRBIMEVE PËR RICIKLIMIN:

Bazuar në studimin e kryer në kuadër të projektit të riciklimit, janë parashikuar 2 itenerare për grumbullimin e mbetjeve të riciklimit, me një frekuencë 3 herë në javë si dhe kostot e gjithë procesit të riciklimit.



Tabela 12: Të dhënat për rrugën 1

Nr. i PGM	88
Numri total i kontejnerëve	88
Numri i punëtorëve/kamionit	3
Koha mesatare për mbledhjen e 1 PGM	2 min
Koha mesatare për shkarkimin e kamionit	10 min
Shpejtësia mesatare e kamionit	16 km/hr.
Distanca totale e rrugës	28.5 km
Pika e fillimit dhe e përfundimit	Magazina – Vend depozitimi



Table 13: Data for route 2

Nr. i PGM	75
Numri total i kontejnerëve	75
Numri i punëtorëve/kamionit	3
Koha mesatare për mbledhjen e 1 PGM	2 min
Koha mesatare për shkarkimin e kamionit	10 min
Shpejtësia mesatare e kamionit	14 km/hr.
Distanca totale e rrugës	26.5 km
Pika e fillimit dhe e perfundimit	Magazina – Vend depozitimi

Tabela 14: Përmbledhje e kostove vjetore për grumbullimin dhe para-trajtimin e mbetjeve të ricikluesshme sipas klasifikimit financiar[24]

Përmbledhje e kostove sipas klasifikimit financiar		
Investimet		
Grumbullimi i mbetjeve	30,520,260	EUR 252,234
INVESTIMET TOTALE TË PËRGJITHSHME [LEK]	**30,520,260**	**EUR 252,234**
Kostot e operimit		
Grumbullimi i mbetjeve	5,844,890	EUR 48,305
Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve	62,193	EUR 514
Nëntotali i kostove operative [lekë/vit]	**5,907,083**	**EUR 48,819**
Kostot e amortizimit		
Grumbullimi i	1,312,503	EUR 10,847
Nëntotali i kostove të amortizimit [lekë/vit]	**1,312,503**	**EUR 10,847**
Kostot e administrimit dhe të ardhurat neto		
Tarifa e administrimit [% e kostos totale]	9%	
Kostoja administrative për mbledhjen e taksave [% e kostos totale]	0%	
Kostoja administrative për fushatën e ndërgjegjësimit publik [% e kostos totale]	0%	
Kostot e administrimit [lekë/vit]	**649,763**	**EUR 5,370**
Të ardhurat neto [% e kostos totale]	4%	
Të ardhurat neto [lekë/vit]	**288,783**	**EUR 2,387**
KOSTOT TOTALE OPERATIVE [LEKË/VITI]	**8,158,132**	**EUR 67,423**
Kostoja totale e funksionimit duke përfshirë administrimin dhe të ardhurat neto për ton mbetje [lekë/t]	**10,996**	**EUR 91**
Kostoja totale e funksionimit duke përfshirë administrimin dhe të ardhurat neto për banor [lekë/ban/vit]	**234**	**EUR 2**
TVSH/VAT 20%	**1,187,015**	**EUR 9,810**
KOSTOT TOTALE OPERATIVE [LEKË/VITI]	**9,345,147**	**EUR 77,233**

***Struktura e personelit dhe niveli I pagave:Riciklimi**

Nr	Emertimi sipas struktures	Nr. Punonjes	Arsimi	Klasa/ Kategoria	Paga e grupit	Paga bazë për klasë/gradë/shtesë pozicioni/paga fikse për funksion/paga fikse për titull	Shtesa per vjetersi ne %	Paga mujore maximale
1	Shofer	2	I mesem/8-9 vjecar	**Klasa VII**	-	43,600	1%	54,500

***Kosto vjetore e personelit per sherbimin e Riciklimit**

Nr	**Emertimi sipas struktures**	**Nr Punonjes**	**Paga mujore**	**Shtesa mbi page 15%**	**Sigurimet mujore 16.7%**	**Kosto mujore**	**Kosto vjetore**
1	Shofer	2	54,500	-	9,102	127.203	1.526.436
Total		**2**				127.203	**1.526.436**

KOSTO TOTALE VJETORE E SHËRBIMIT TË RICIKLIMIT

Nr	**Emertimi**	**Shuma ne leke**
1	Kosto Personeli	1.526.436
	Total	**1.526.436**

1. MATERIALI SHPJEGUES I ZËRAVE TË SHËRBIMEVE PËR QENDRËN HISTORIKE DHE SHTRATIN E LUMIT

<u>Zërat e Shërbimeve për mirëmbajtjen e lagjeve:</u>

a) Mangalem

- Mirëmbajtje, pastrim rrugice dhe sheshi "Selamlliku".
- Pastrim dhe prerje bari 2 herë në vit.

b) Goric

- Mirëmbajtje, pastrim rrugice dhe shtratit të lumit në zonën e Goricës.
- Pastrim dhe prerje bari 2/4 herë në vit.

c) Kala

- Mirëmbajtje, pastrim rrugice dhe sheshesh.
- Pastrim e prerje bari (2/4 herë/vit)

d) Rr. Mihal Komneno

- Mirëmbajtje, pastrim rr. Mihal Komneno (Xhamia Mbret, Muzeu Etnografik)
- Pastrim e prerje bari (2/4 herë/vit)

e) Strati i Lumit Osum

- Mirëmbajtje, pastrim shtratit të lumit Osum
- Pastrim e prerje bari (2/4 herë/vit)

2. PASQYRAT PËRMBLEDHËSE E ANALIZËS SË KOSTOS

- Pasqyrë përmbledhëse të dhënave bazë për analizën e kostos për mirëmbajtjen e lagjeve.

Nr	Emertimi	Sip. Rruge&sheshe m2	Sip. Bari	Tot
I	**Mirwmbajtja e lagjeve Tot**	**42715 m^2**	**62764 m^2**	**105479 m^2**
1	Mangalem	8 177 m^2	-	**8177 m^2**
2	Goric	5 654 m^2	8500 m^2	**14154 m^2**
3	Kala	16 740 m^2	30 000 m^2	**46740 m^2**
4	Rr. Mihal Komneno	10 341 m^2	3510 m^2	**13851 m^2**
5	Shtrati i Lumit Osum	2870 m^2	19687 m^2	**22557 m2**

Shënojmë se Sipërfaqja në mirëmbajtjen e lagjeve janë kryer matje në të gjitha rrugicat dhe sheshet.

- Pasqyrë përmbledhëse e bazës së të dhënave për analizën e kostos për mirëmbajtjen e lagjeve dhe shtrati të lumit

Nr	Emertimi i Sherbimeve	Njesia e matjes	Sasia	Qyteti Beratit			
				Mangalem	Goric	Kala	Rr. Mihal Komneno
1	Mirëmbajtje dhe pasatrim	dite	365	365	365	365	365
2	Pastrim sip. bari	m^2	42 010	-	8500	30 000	3510
3	Pastrim rrugë e sheshe	m^2	40 912	8177	5 654	16 740	10 341

- Pasqyrë përmbledhëse e bazës së të dhënave për analizën e kostos për pastrimin e Shtratit të lumit Osum

Nr.	Emërtimi i Shërbimeve	Njesia	Sasia
1	Mirëmbajtje shtratit të lumit	ditë	365
2	Pastrim e prerje bari (2 herë/vit)	m^2	2870
3	Prerje bari (4 herë/vit)	m^2	19687

3. KOSTO PËR KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË PËRCAKTUARA

a. Kosto Personeli
b. Kosto Materiale dhe të tjera kosto operative
   - Materiale për shërbimin e mirëmbajtjes sw lagjeve
   - Materiale për shërbimin e mirwmbajtjes sw bregut tw lumit
c. Kosto Vegla Pune, mjete pune, me afat përdorimi mbi 1 vit

a. Kosto Personeli:

Numri i nevojshëm i personelit:

- Për kryerjen e shwrbimeve të mirëmbajtjes nevojiten 2 punëtor shërbimesh në lagjen Mangalem, 2 punëtor shërbimesh në Goric, 4 puntor shwrbimesh nw lagjen Kala, 2 punëtor shërbimesh në rr. Mihal Komeno, 2 punëtor shërbimesh në shtratin e Lumit Osum dhe 4 puntorë për prerje bari në të gjithë zonat sipërcituara.
  Total punëtorë shërbimesh: **16 punëtorë, 1 Administrator dhe 1 Financier**

Struktura e personelit dhe niveli i pagave :

Nr	Emertimi sipas struktures	Nr. Punonjes	Arsimi	Klasa/Kategoria	Paga e grupit	Paga bazë për klasë/gradë/shtesë pozicioni/paga fikse për funksion/paga fikse për titull	Shtesa per vjetersi ne %	Paga mujore maximale
1	Administrator	1	I larte	**IIb**	14.000	73.900	2%	94.900
2	Punetor mirembajtes	16	I mesem/8-9 vjecar	**Klasa I**	-	40.000	1%	50.000
3	Specialist Finance	1	I larte	**IIIb**	14000	56.000	2%	77.000

Kosto vjetore e personelit :

Nr	Emertimi sipas struktures	Nr Punonjes	Paga mujore	Shtesa mbi page 15%	Sigurimet mujore 16.7%	Kosto vjetore/total	Kosto e sherbimit te pastrimit
1	Administrator	1	94.900	-	15.848	1.328.980	664,490,00
2	Punetor mirembajtes	16	50.000	-	8.350	14.704.200	11.203.200
3	Specialist Finance	1	77.000	-	12.859	1.078.308	1.078.308
(a)Total		**18**					**12.945.998**

Shenim: Kostoja e pozicionit te Pergjegjesit eshte e ndare mes struktures se sherbimit te pastrimit dhe struktures se venddepozitimit.
Kostoja e pozicionit te punonjesve mirembajtes ne sektorin e pastrimit eshte perllogaritur duke u bazuar ne fashen orare te punes 07:00-19:00 (pas ketij kufiri ka shtese mbi pagen e punonjesit).

b. Materiale dhe të tjera kosto operative

- **Materiale për shërbimin e mirëmbajtjes së lagjeve muzeale dhe shtratit të lumit Osum**

Nr	Emertimi	Njesia e matjes	Sasia Vjetore	Cmim/njesi pa tvsh	Kosto vjetore lek
1	Veshje pune profesionale me shirita fosforeshente(kominoshe),me material pambuku	pale	16	1.850	29.600
2	Cizme pune te shkurtra shiu,me material PVC	pale	16	1.300	20.800
3	Doreza pune me veshje lekure	pale	16	133	2.128
4	Pelerine shiu me shirit fosforeshent,me material PVC	cope	16	1.600	25.600
5	Fshese plastike	cope	16	453	7.248
6	Radap per sperkatjen(trajtim kimik)	litra	100	1.367	136.700
7	Syze pune	cope	16	573	9.168
8	Jelek pune	cope	16	192	3.072
9	Qese te zeza(120lt)	cope	1.000	213	213.000
(b)Total Materiale					447.316

Burimi: Jane marre ne shqyrtim tre oferta nga biznese te ndryshme per te nxjerre nje mesatare per cmim te produktit. (Dokumentet bashkengjitur).

c.Vegla pune, pajisje, mjete

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmim/njesi	Kosto lek
1	Karroce dore metalike(me peshe mbajtese deri ne 100kg)	cope	8	4.200	33.600
2	Gershere metalike manuale per prerje bari/krasitje	cope	6	1.233	7.398
3	Kose bari prej celiku special me bisht druri(me gjatesi tehu 650mm)	cope	10	1.800	18.000
4	Kreher bari metalik me bisht druri	cope	16	683	10.928

5	Pompa me bateri per sperkatje	cope	11	4.083	44.913
6	Prashites metalik per bime me lule me dy krahe	cope	16	933	14.928
7	Lopate katrore celiku me bisht druri	cope	16	1.183	18.928
8	Kazma(capa)	cope	16	1.150	18.400
9	Makine korrese	cope	2	18.333	36.666
10	Steka per prerjen e barit	cope	14	35.667	499.338
11	Disqe(per steken)	cope	14	3.000	42.000
12	Fill(per steken)	ml	1200	83	99.600
13	Sfurqe	cope	16	1.267	20.272
	Shuma				864.971
	Te tjera operative 2%				17.300
(c)Total Materiale dhe te tjera operative					**882.271**

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia/vit	Cmim/njesi	Kosto vjetore
1	Karburant(benzine) steka	lt	480	192	92.160
(d)Total karburant steka					**92.160**

Burimi: Jane marre ne shqyrtim tre oferta nga biznese te ndryshme per te nxjerre nje mesatare per cmim te produktit. (Dokumentet bashkengjitur)
Cmimi i karburantit i eshte referuar cmimit te tregut date 16.08.2023

Burimi: Cmimi i kamionit vetshkarkues është llogaritur ne baze te cmimit mesatar marre nga anetaret e komisionit.

KOSTO TOTALE VJETORE E SHËRBIMIT TË MIRËMBAJTJES SË LAGJEVE MUZEALE DHE TË SHTRATIT TË LUMIT

Nr	Emertimi	Shuma ne leke
1	Kosto Personeli	12.945.998
2	Kosto Materiale dhe te tjera operative	447.316
3	Kosto Vegla,mjete pune	882.271
4	Total karburant steka	92.160
5	**Tvsh (2+3)**	265.917
Total Kosto vjetore(a+b+c+d+e)		**14.633.662**

1. **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

   a. **<u>Shërbimi i mirëmbajtjes së lagjeve muzeale:</u>**

Lagjja Mangalem

- **Mirëmbajtje, pastrim rrugice dhe sheshi "Selamlliku"**. Ky është një proçes pune në vazhdimësi për gjithë vitin 365 ditë dhe përfshin mirëmbajtjen e gjithë rrugicave dhe sheshit Selamlliku. Mbeturinat mblidhen edhe më pas depozitohen në vëndet e paracaktuara nga Bashkia. Sipërfaqja është llogaritur rreth 8177 m^2.
- **Prerje bari 2 herë në vit**. Në këtë zë punimi nënkuptohet pastrim dhe prerja e barit 2 herë në vit me trajtim kimik me radap (spërkatje) dhe 2 herë me mjete korrëse dore (steka). Sipërfaqja totale është llogaritur rreth 8177 m^2.

  Norma e konsumit te Radapit 1 lit – 1000m^2
  8177 m^2 = 8,177 lit x2 (herë/vit)= **16.35 lit radap/vit**
  Norma e konsumit të karburantit (benzin) = 15 lit – 10000 m^2
  8177 m^2= 12.265 lit x2 (herë/vit) = **24.53 lit benzin/vit**
  Norma e konsumit te fillit te stekes ne rrugice 50 m linear - 10000m^2
  8177 m^2= 40.88 m x2 (herë/vit) = **81.76 m linear/vit fill steke**

Shënim: Normat e konsumit janë llogaritur në bazë të informacioneve të marra nga ndërrmarrja ASHP (Sektori Gjelbërimit)

Lagjja Goricë

- **Mirëmbajtje, pastrim rrugice dhe shtratit të lumit në zonën e Goricës**. Ky është një proçes pune në vazhdimësi për gjithë vitin 365 ditë dhe përfshin mirëmbajtjen e gjithë rrugicave dhe shtratit të lumit në zonën e Goricës. Mbeturinat mblidhen edhe më pas depozitohen në vëndet e paracaktuara nga Bashkia. Sipërfaqja për pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrugicave është llogaritur rreth 5654 m^2 dhe mirëmbajtja e sipërfaqes së shtratit të lumit në territorin e lagjes Goricë është 8500 m^2.
- **Prerje bari 2 herë në vit**. Në këtë zë punimi nënkuptohet pastrim dhe prerja e barit 2 herë në vit me trajtim kimik me radap (spërkatje) dhe 2 herë me mjete korrëse dore (steka). Sipërfaqja totale është llogaritur rreth 14154 m^2.

  Norma e konsumit te Radapit 1 lit – 1000m^2
  5654 m^2 = 5,654 lit x2 (herë/vit) = **11.3 lit radap/vit**
  Norma e konsumit të karburantit (benzin) = 15 lit – 10000 m^2
  14154 m^2= 21.23 lit x2 (herë/vit) = **42.46 lit benzin/vit**
  Norma e konsumit te fillit te stekes ne rrugice 50 m linear - 10000m^2
  5654 m^2= 28.27 m x2 (herë/vit) = **56.54 m/vit fill steke**
  Norma e konsumit te fillit te stekes ne sip.bari 30 m linear - 10000m^2
  8500 m^2= 25.5 m x2 (herë/vit) = **51 m linear /vit fill steke**

Lagjja Kala

- **Mirëmbajtje, pastrim rrugice dhe sheshesh.** Ky është një proçes pune në vazhdimësi për gjithë vitin 365 ditë dhe përfshin mirëmbajtjen e gjithë rrugicave, shesheve dhe territorin rreth e përqark kalasë. Mbeturinat mblidhen edhe më pas depozitohen në vëndet e paracaktuara nga Bashkia. Sipërfaqja e llogaritur është 16740 m^2 rrugica dhe sheshe dhe 30000 m^2 sip. bari.
- **Prerje bari 2/4 herë në vit**. Në këtë zë punimi nënkuptohet pastrim dhe prerja e barit 2 herë në vit me trajtim kimik me radap (spërkatje) nëpër rrugica dhe 2 herë me mjete korrëse dore (steka) në sipërfaqe 16740 m^2 dhe prerje e barit 4 herë në vit me mjete korrëse dore (steka) dhe makinë korëse në sipërfaqe bari 30000 m^2.

  Norma e konsumit te Radapit 1 lit – 1000 m^2
  16740 m^2 = 16.740 lit x2 (herë/vit) = **33.48 lit radap/vit**
  Norma e konsumit të karburantit (benzin) = 15 lit – 10000 m^2
  16740 m^2= 25.11 lit x 2 (herë/vit rrugicë) = **50.22 lit benzin/vit**
  30000 m^2= 45 lit x 4 (herë/vit sip. gjelbërt) = **180 lit benzin/vit**
  Norma e konsumit te fillit te stekes ne rrugice 50 m linear – 10000 m^2
  16740 m^2= 83.7 m x2 (herë/vit) = **167.4 m/vit fill steke**
  Norma e konsumit te fillit te stekes ne sip.bari 30 m linear – 10000 m^2
  30000 m^2= 90 m x 4 (herë/vit) = **360 m linear /vit fill steke**

Rr. Mihal Komneno

- **Mirëmbajtje, pastrim rr. Mihal Komneno.** Ky është një proçes pune në vazhdimësi për gjithë vitin 365 ditë dhe përfshin mirëmbajtjen e rrugicave dhe territorin pranë xhamisë Mbret, muzeut Etnografik dhe rrugës Mihal Komneno. Mbeturinat mblidhen edhe më pas depozitohen në vëndet e paracaktuara nga Bashkia. Sipërfaqja e llogaritur është 13851 m^2 nga të cilat 10341 m^2 janë sip. rrugice dhe rruge dhe 3510 m^2 bari.
- **Prerje bari 2/4 herë në vit**. Në këtë zë punimi nënkuptohet pastrimi dhe prerja e barit 2 herë në vit me trajtim kimik me radap (spërkatje) dhe 2 herë me mjete korrëse dore (steka) sip. rrugice 10341 m^2 dhe 4 herë në vit me mjete korrëse dore (steka) në sipërfaqe bari 3510 m^2.

  Norma e konsumit te Radapit 1 lit – 1000 m^2
  10341 m^2 = 10.341 lit x2 (herë/vit) = **20.682 lit radap/vit**
  Norma e konsumit të karburantit (benzin) = 15 lit – 10000 m^2
  10341 m^2= 15.51 lit x 2 (herë/vit rrugicë) = **31.02 lit benzin/vit**
  3510 m^2= 5.265 lit x 4 (herë/vit sip. gjelbërt) = **21.06 lit benzin/vit**
  Norma e konsumit te fillit te stekes ne rrugice 50 m linear – 10000 m^2
  10341 m^2= 51.7 m x2 (herë/vit) = **103.4 m/vit fill steke**
  Norma e konsumit te fillit te stekes ne sip.bari 30 m linear – 10000 m^2
  3510 m^2= 10.53 m x 4 (herë/vit) = **42.12 m linear /vit fill steke**

Shtrati i Lumit Osum

- **Mirëmbajtje, pastrim shtratit të lumit Osum.** Ky është një proçes pune në vazhdimësi për gjithë vitin 365 ditë dhe përfshin mirëmbajtjen e pjesës ballore të ishullit, gjithë shtratit të lumit në rrugën kryesore (bashkëlidhur harta treguese, shëtitore Osumi - Rr. Antipatrea). Mbeturinat mblidhen edhe më pas depozitohen në vëndet e paracaktuara nga Bashkia. Sipërfaqja është llogaritur rreth 19687 m^2 gjithashtu dhe 2870 m^2 pastrim murri.
- **Prerje bari 2/4 herë në vit**. Në këtë zë punimi nënkuptohet pastrimi dhe prerja e barit 2 herë në vit me trajtim kimik me radap (spërkatje) dhe 2 herë me mjete korrëse dore (steka) në sip. e murrit 2870 m^2 dhe 4 herë në vit me mjete korrëse dore (steka) në sipërfaqe bari 19687 m^2.

  Norma e konsumit te Radapit 1 lit – 1000 m^2
  2870 m^2 = 2.87 lit x2 (herë/vit) = **5.74 lit radap/vit**
  Norma e konsumit të karburantit (benzin) = 15 lit – 10000 m^2
  2870 m^2= 4.305 lit x 2 (herë/vit murri) = **8.61 lit benzin/vit**
  19687 m^2= 29.53 lit x 4 (herë/vit sip. gjelbërt) = **118.12 lit benzin/vit**
  Norma e konsumit te fillit te stekes ne sip.murri 50 m linear – 10000 m^2
  2870 m^2= 14.35 m x2 (herë/vit) = **28.7 m linear/vit fill steke**
  Norma e konsumit te fillit te stekes ne sip.bari 30 m linear – 10000 m^2
  19687 m^2= 59.06 m x 4 (herë/vit) = **236.24 m linear /vit fill steke**

- ***<u>Zërat e Shërbimeve për Venddepozitimin:</u>***

a) Shperndarja, kompaktimit, ngjeshja dhe mbulimi me dhè;

b) Ngritja e tubave te gazit mbushjen e tyre me material drenazhi;

c) Mirembajtja e venddepozitimit dhe prerje bari 2 herë në vit;

PASQYRA E ANALIZËS SË KOSTOS

a. Pasqyrë përmbledhëse të dhënave bazë për analizën e kostos për mirëmbajtjen e venddepozitimit.

Nr	Emertimi	Sip.
I	**Mirëmbajtja Tot (prerje bari + pastrim)**	**4.5 ha**
1	Mirembatje e zones se pare + prerje bari	14 000 m^2
2	Sip. ku depozitohen mbetjet	18 525 m^2
3	Sip. vaska Dekantim dhe Evapurim	1 600 m^2
4	Mirembajtje dhe prerje bari	10 875 m^2

b. Pasqyrë përmbledhëse e bazës së të dhënave për analizën e kostos për mirëmbajtjen e venddepozitimit Bashkia Berat

Nr	Emertimi i Sherbimeve	Njesia e matjes	Sasia
1	Depozitimi i Mbetjeve	dite	**365**
2	Mirembajtja e venddepozitimit	m^2	**45 000**
3	Pastrim e prerje bari	m^2	**24 875**

b. **KOSTO PËR KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË PËRCAKTUARA**

d. Kosto Personeli
e. Kosto Materiale dhe të tjera kosto operative
   - Materiale për shërbimin e mirëmbajtjes së venddepozitimit
   - Materiale për shërbimin e grumbullimit te mbetjeve
f. Kosto Vegla Pune, mjete pune, me afat përdorimi mbi 1 vit

b. Kosto Personeli:

Numri i nevojshëm i personelit:

- Për kryerjen e sherbimeve të mirëmbajtjes nevojiten 1 punëtor per perdorimin e mjetit bulldozer, 2 puntor per mirembajtjen, prerjen e barit, ngritjen e tubave, etj .
  Total punëtorë shërbimesh: 3 puntorë

Struktura e personelit dhe niveli i pagave :

Nr	Emertimi sipas struktures	Nr. Punonjes	Arsimi	Klasa/Kategoria	Paga bazë për klasë/gradë/shtesë pozicioni/paga fikse për funksion/paga fikse për titull	Shtesa per vjetersi ne %	Paga mujore maximale
1	Punetor manovrator	1	I mesem/8-9 vjecar	**Klasa III**	41.800	1%	52.250
2	Punetor sherbimi mirembajtje ne venddepozitim	2	I mesem/8-9 vjecar	**Klasa I**	40.000	1%	50.000

Kosto vjetore e personelit :

Nr	Emertimi sipas struktures	Nr Punonjes	Paga mujore	Shtesa mbi page 15%	Sigurimet mujore 16.7%	Kosto vjetore/total	Kosto e sherbimit te venddepozitimit
1	Pergjegjes	1	91.000	-	15.197	1.274.364	637.182
2	Punetor Manovrator	1	52.250	-	8.726	731.709	731.709
3	Punetor Mirembajtes	2	50.000	-	8.350	1.400.400	1.400.400
Total							**2.769.291**

Shenim: Kostoja e pozicionit te Pergjegjesit eshte e ndare mes struktures se sherbimit te pastrimit dhe struktures se venddepozitimit.

Materiale dhe të tjera kosto operative

- **Materiale për shërbimin e mirëmbajtjes së venddepozitimit**

Nr	Emertimi	Njesia e matjes	Sasia Vjetore	Cmim/njesi pa tvsh	Kosto vjetore leke
1	Veshje pune profesionale me shirita fosforeshente(kominoshe),me material pambuku	pale	3	1.850	5.550
2	Cizme pune te shkurtra shiu,me material PVC	pale	3	1.300	3.900
3	Doreza pune me veshje lekure	pale	3	133	399
4	Pelerine shiu me shirit fosforeshent,me materia PVC	cope	3	1.600	4.800
5	Fshese plastike	cope	3	453	1.359
6	Radap per sperkatjen(trajtim kimik)	litra	50	1.367	68.350
7	Syze pune	cope	3	573	1.719
8	Jelek pune	cope	3	192	576
	Shuma				86.653
	Te tjera operative 2%				1.733
	Total Materiale dhe te tjera operative				**88.386**

Shenim: Jane marre ne shqyrtim tre oferta nga biznese te ndryshme per te nxjerre nje mesatare per cmim te produktit. (Dokumentet bashkengjitur)

f) Vegla pune, pajisje, mjete

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmim/njesi	Vlera ne leke
1	Karroce dore metalike(me peshe mbajtese deri ne 100kg)	cope	2	4.200	8.400
2	Gershere metalike manuale per prerje bari/krasitje	cope	2	1.233	2.466
3	Kose bari prej celiku special me bisht druri(me gjatesi tehu 650mm)	cope	2	1.800	3.600
4	Kreher bari metalik me bisht druri	cope	2	683	1.366
5	Lopate katrore celiku me bisht druri	cope	2	1.183	2.366
6	Steka per prerjen e barit	cope	2	35.667	71.334
7	Disqe(per steken)	cope	2	3.000	6.000
8	Fill(per steken)	ml	150	83	12.450
9	Sfurqe	cope	2	1.267	2.534
	Shuma 1				**110.516**

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmim/njesi me tvsh	Vlera ne leke
1	Karburanti(Benzine)	lt	80	192	15.360
	Shuma 2				**15.360**
	Shuma (1+2)				**125.876**

Burimi:Jane marre ne shqyrtim tre oferta nga biznese te ndryshme per te nxjerre nje mesatare per cmim te produktit. (Dokumentet bashkengjitur)
Cmimi i karburantit i eshte referuar cmimit te tregut date 16.08.2023

***Shpenzime makinerie(kosto e shfrytezimit) Buldozier**

Nr	Emertimi	Nr I makinerive	Norma e harxhimit(lit/ore)	Kohezgjatja(ore)/vit	Cmimi njesi me tvsh (leke)	Vlera ne leke
1	Buldozier	1	20	1440	190	273.600
	Total karburant/vit(1)					**273.600**
Nr	**Emertimi**	**% perdorimit**				**Leke/vit**
1	Mirembajtje,riparime,filtra,vaj hidraulik+motori	100%				121.000
	Total/vit(2)					**121.000**
Nr	**Amortizimi**	**Norme amortizimi**	**% e perdorimit**	**muaj**	**Cmimi**	**Kosto amortizimi**
1	Buldozier	0,05	100%	12	9.686.589	484.329,45
	Total (3)					**484.329**
Shuma total vjetore(1+2+3)						**878.929**

Burimi: Kohezgjatja e makinerise eshte 4 ore ne dite, informacioni eshte bazuar ne Studimin e Pastrimit te vitit 2019.
Shpenzimet per mirembajtjen jane llogaritur ne baze te informacioneve te marra nga nderrmarrja ASHP per mjetin buldozier.
Cmimi i karburantit i eshte referuar cmimit te tregut date 16.08.2023.

- *Analize cmimesh per kryerjen e punimeve ne venddepozitim ne nje vit

Materialet per puset	Njesia	Sasia	Cmimi pa tvsh	Vlera ne leke
Tub korrogato HDPE DN 200mm, SN 4	m	70	733	51310
Drenazh/gur me dimension 10-15cm	m3	50	967	48350
Tel xingato d=4 mm	kg	2	617	1234
Rrrjete teli me dimensione 80x100mm,d=2.7mm me h=1.2,gjatesi 20m	cope	5	4833	24165
Total				**125.059**

KOSTO TOTALE VJETORE E SHËRBIMIT TË MIRËMBAJTJES SË VENDDEPOZITIMIT

Nr	Emertimi	Shuma ne leke
1	Kosto Personeli	2.769.291
2	Kosto Materiale dhe te tjera operative	88.386
3	Kosto Vegla,mjete pune	125.876
4	Shuma(Materiale per puset)	125.059
5	**Tvsh (2+3+4)**	54.986
6	Shpenzime makinerie	878.929
	Total Kosto(1+2+3+4+5)	**4.042.528**

SPECIFIKIMET TEKNIKE

a. Shërbimi i mirëmbajtjes së venddepozitimit:

- **Mirëmbajtje, pastrim venddepozitimi.** Ky është një proçes pune në vazhdimësi për gjithë vitin 365 ditë dhe përfshin mirëmbajtjen e venddepozitimit. Mbeturinat mblidhen edhe më pas depozitohen në venddgrumbullim. Gjithashtu ne kete ze sherbimi perfshihet dhe ngritja e tubave te gazit edhe mbushjen e tyre me material drenazhi. Kontrolli i vaskave të dekantimit dhe evapurimit. Sipërfaqja është llogaritur rreth 45000 m^2.

- **Prerje bari 2 herë në vit**. Në këtë zë punimi nënkuptohet pastrim dhe prerja e barit 2 herë në vit me mjete korrëse dore (steka). Sipërfaqja totale është llogaritur rreth 24875 m^2.
- **Sistemi dhe ngjeshja e mbetjeve.** Ky është një proçes pune në vazhdimësi për gjithë vitin 365 ditë dhe përfshin sistemin, ngjeshjen dhe mbulimin me dhè çdo ditë të mbetjeve me mjetin buldozer.

Norma e konsumit te Radapit 1 lit – 1000 m^2
24875 m^2 = 24.88 lit x2 (herë/vit) = **49.8 lit radap/vit**
Norma e konsumit të karburantit (benzin) = 15 lit – 10000 m^2
24875 m^2= 37.3 lit x 2 (herë/vit) = **74.6 lit benzin/vit**
Norma e konsumit te fillit te stekes ne sip.bari 30 m linear – 10000 m^2
24875 m^2= 74.6 m x 2 (herë/vit) = **149.2 m linear /vit fill steke**

Shënim: Normat e konsumit janë llogaritur në bazë të informacioneve të marra nga ndërrmarrja ASHP (Sektori Gjelbërimit)

- STRUKTURAT KRYESORE TË VENDDEPOZITIMIT

Venddepozitimi shtrihet në një sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 4.5 ha duke përfshirë disa nënstruktura të nevojshme për një venddepozitim të kontrolluar. Ndodhet në Orizaj, Njësia administrative Otllak, rreth 1 km larg nga rruga nacionale dhe rreth 5 km larg nga qëndra e qytetit. Ky venddepozitim përdoret që prej vitit 1980 dhe ka koordinatat (Sistemi UTM) E 34T0409837; S 4509331.
Në mbështetje të Projektit të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta në Qarkun Berat në bashkinë Berat u mundësua investimi i rehabilitimit të sheshdepozitimit të mbetjeve urbane, i cili u realizuar me mbështetjen e Qeverisë së Zvicrës nëpërmjet SECO dhe zbatuar nga INFRASTRUKTUR & UMËELT, në konsorcium me SEHLHOFF dhe FLAG.
Ai është projektuar dhe ndërtuar si një strukturë e vetme dhe me të gjithë infrastrukturën e nevojshme shoqëruese duke marrë në konsideratë dy faza (atë të asgjesimit të mbetjeve ekzistuese të hedhura në mënyrë të pakontrolluar (të përfunduar) dhe atë të asgjesimit të mbetjeve që do të gjenerohen në vijim deri në momentin e ndërtimit të një venddepozitimi të ri). Kjo qasje ka të bëjë me reduktimin e ndotjes së shkaktuar nga hedhja e pakontrolluar e mbetjeve, minimizimin e ndotjes në vijim dhe parandalimin e saj në periudhë afatgjatë.

Për të dy këto zona, ose faza asgjesimi mbetjesh të ngurta urbane në mënyrë të kontrolluar është ndërtuar dhe përdoret e njëjta zonë shërbimi, i njëjti sistem menaxhimi për lëngun kullues nga venddepozitimi dhe drenazhimi për ujërat atmosferike si dhe e njëjta metodologji e kapjes së gazit.

Projekti i Menaxhimit të Mbetjeve ka bërë të mundur:
- Evitimin që mbetjet të bihen në lumen Osum;
- Evitimin që mbetjet të lëvizen nga era/uji etj siç ndodhte kohë më parë;
- Reduktimi i çlirimeve të gazi dhe erës së keqe nga vend depozitimi i mbetjeve;

- Reduktimi i ndikimit në cilësinë e ajrit dhe efektin e gazeve të serave në klimën globale;
- Shmnagja e ujit që grumbullohet brenda venddepozitimit me qëllim që të reduktojë riskun e rrëshqitjes nga toka;
- Rikthimi i florës lokale/vegjetimit /peisazhit natyror;
- Shpatet dhe muri i zonës operacionale të vend depozitimit përbën një barrier rreth mbetjeve e cila lejon të fshehë operimin e venddepozitimit të mbetjeve, duke reduktuar ndikimin në peisazh;



Fig nr.1. Venddepozitimi i mbetjeve urbane

Strukturat kryesore të marra në konsideratë për të dy fazat janë:

- Zona e asgjesimit të kontrolluar të mbetjeve ekzistuese mbas mbylljes (Faza e parë);
- Zona e asgjesimit të kontrolluar të mbetjeve që do të gjenerohen në vijim (Faza e dytë);
- Sistemi i drenazhimit dhe trajtimit të lëngut kullues nga venddepozitimi;
- Sistemi i drenazhimit të ujërave atmosferike;
- Sistemi i mbledhjes së gazit;
- Porta hyrëse dhe rrethimi;
- Shërbime shtesë dhe plotësuese (sheshi që do të përdoret për riciklim, kompostim dhe transferim të mbetjeve në të ardhmen, zyrat, rrugët e brendshme dhe perimetrale, furnizimi me energji, ndriçimi dhe furnizimi me ujë).

Jetëgjatësia e këtij venddepozitimi, specifikisht zona e re e asgjesimit të mbetjeve, do të jetë 5 vjet dhe nëse parashikohen ndërhyrje dytësore (diferencimi, kompostimi), atëherë koha e përdorimit të kësaj infrastrukture rritet.

Me vendosjen e mbetjeve në venddepozitim, ngjeshjen e tyre dhe mbulimin përfundimtar krijohen kushte të favorshme për dekompozimin si rezultat i të cilit nis prodhimi i lëngut kullues dhe gazit. Për të parandaluar infiltrimin e tyre në tokë dhe për të evituar shkarkime të pakontrolluara të gazit në mjedis, infrastruktura përkatëse është përmbledhur si më poshtë:

- Në bazament dhe skarpatat e brëndshme të argjinaturës në venddepozitim është vendosur një shtresë 20 cm argjile/dheu si shtresë e padepërtueshme nga uji, e cila nuk do të lejojë filtrimin e lëngut kullues nga mbetjet e depozituara në nënshtresat e tokës mbi të cilën është vendosur venddepozitimi. Në bazamentin e tij janë ndërtuar një sistem kanalesh (në çdo 22 m), mbi të cilët është vendosur shtresë drenazhimi 3-15 mm me material zhavorri për mbledhjen e ujërave brënda venddepozitimit dhe largimin prej tij për në sistemin e mbledhjes dhe menaxhimit të lëngut kullues.

- Mbledhjen e lëngut kullues mbas daljes nga venddepozitimi nëpërmjet një sistemi pusetash grumbullimi dhe një linjë sekondare (tub HDPE, DN=200 mm). Kalimin në një sistem basenesh lagunor të hapur, i pari, basen evaporimi në të cilin, nën efektin e agjentëve atmosferike, specifikisht temperaturës, kryhen evaporimi/avullimi i ujit dhe i dyti, basen sedimentimi i ajrosur mirë në të cilin presupozohet se llumrat e aktivizuara në shtresën e sipërme dhe sedimentimi zhvillohen njëkohësisht duke precipituar në fund të basenit dhe prej këtej ujërat shkarkohen në një sistem pusetash për në daljen fundore.

- Prodhimi i biogazit varet nga një sërë parametrash ku më kryesoret janë përbërja e mbetjeve, mosha, temperatura, lagështia në venddepozitim, era, etj. Në mbetjet e ngurta urbane të depozituara në mënyrë të kontrolluar krijohen kushte të favorshme për proçese fiziko-kimike. Sistemi i kapjes së gazit në zonën e rehabilituar është sistem pasiv dhe infrastruktura e kapjes është e njëjtë për të dy fazat e asgjesimit të mbetjeve.

- Shtresa e mbulimit përfundimtar është (faza e parë) dhe do të jetë një shtresë prej 110 cm dhe ka si qëllim inkapsulimin/izolimin e mbetjeve nga agjentët atmosferikë dhe ndërpret kontaktin me mjedisin përreth, përfshirë njerëzit, kafshët dhe shpendët, ndërkohë që përshtat peizazhin nëpërmjet vegjetacionit. të ndërtuar në bazamentin e venddepozitimit.

Zona e asgjesimit të mbetjeve

Zona e asgjësimit të mbetjeve është e konceptuar në dy seksione ku e para përfaqëson zonë të rehabilituar të mbetjeve të hedhura në mënyrë të pakontrolluar dhe e dyta përfaqëson zonë të kontrolluar të asgjesimit të mbetjeve që do të gjenerohen në vijim, jetëgjatësia e së cilës është llogaritur të jetë 5 vjet deri në momentin e ndërtimit të një vend depozitimi rajonal të integruar.

Zona e rehabilituar/ e asgjesimit të kontrolluar të mbetjeve ekzistuese mbas mbylljes (Faza e parë)

Kjo zonë e venddepozitimit zë një sipërfaqe prej 14000 m2 ku është sistemuar një volum prej 68000 m^3 mbetje ekzistuese me një lartësi maksimale prej 7 m. Me vendosjen e mbetjeve në

venddepozitim, ngjeshjen e tyre dhe mbulimin përfundimtar krijohen kushte të favorshme për dekompozimin si rezultat i të cilit nis prodhimi i lëngut kullues dhe gazit.

Zona e asgjesimit të Kontrolluar të mbetjeve (Faza e dytë)

Zona e asgjesimit të mbetjeve, faza e dytë, është projektuar për një volum prej 135600 m^3 mbetje për pesë vitet në vijim. Ajo është ndërtuar në vazhdim të zonës së përfunduar të depozitimit të mbetjeve ekzistuese, në sipërfaqe prej 18525 m^2 dhe lartësi maksimale të trupit të mbetjeve në fund të jetës së saj 7 m. Sasia e mbetjeve që do të depozitohet në venddepozitim do të jetë 90 000 t. Forma gjeometrike e konfiguracionit të venddepozimit mbas mbylljes së tij do të jetë në përshtatje të peizazhit rrethues duke kultivuar shtresa rreth 2 m të larta, por faqja ballore/skarpata do të ruajë pjerrësi në përputhje me terrenin ose sikundër është përcaktuar në projektin teknik, pjerrësinë 2:3.

Menaxhimi i venddepozitimit në përputhje me kushtet teknike të operimit dhe mirëmbajtjes gjatë fazës operacionale

Menaxhimi i venddepozitimit përfshin proçesin e asgjesimit të mbetjeve, menaxhimit të gazit, lëngut kullues dhe ujërave atmosferike si në fazën operacionale ashtu edhe post mbylljes së tij ku të gjitha proçeset, së bashku, varen nga sjellja e mbetjeve dhe metoda e asgjesimit të tyre. Për këtë, gjatë kryerjes së proçeseve të punës apo aktiviteteve në zonën e asgjesimit të mbetjeve duhet të merren në konsideratë si më poshtë:

- Formimi i një trupi të vetëm mbetjesh, gjeometrikisht uniform, dhe reliev të qendrueshëm gjatë fazës operacionale.
- Kufizimi dhe reduktimi i depërtimit të ujërave atmosferikë në trupin e mbetjeve, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen artificiale të sasisë së lëngut kullues nga venddepozitimi, në proçesin e formimit të gazit dhe në qëndrueshmërinë e shtresave të kultivimit dhe mbulesës duke shkaktuar efekte negative në mjedis dhe rrjedhimisht rritje të kostove operative.
- Menaxhimi dhe kontrolli korrekt i sistemit të drenazhimit, grumbullimit dhe trajtimit të lëngut kullued nga venddepozitimi deri në shkarkimin fundor.
- Menaxhimi dhe kontrolli i sistemit të kapjes dhe shkarkimit të gazit.
- Menaxhimi efikas i burimeve njerëzore dhe teknologjike të disponueshme në objekt.

Dorëzimi i mbetjeve

Kontrolli i mbetjeve të destinuara për në venddepozitim është një masë për parandalimin potencial të impakteve në mjedis si:

- përhapja e mbetjeve dhe lëngut kullues në tokë, në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore
- përhapja e pluhurave dhe gazit në atmosferë.

Çdo person që dorëzon mbetje, përpara se të hyjë në venddepozitim duhet t'i paraqesë personelit përgjegjës dokumentacionin ose autorizimet e nevojshme, nëpërmjet të cilit ai lejohet që të kryejë dorëzimin e mbetjeve në venddepozitim, ndërsa për mbetjet hyrëse (përveç mbetjeve të ngurta komunale), dokumentacionin që vërteton dhe siguron se transportuesi është i autorizuar nga autoritetet lokale për të dorëzuar këto mbetje në venddepozitimin e kontrolluar. Mjetet që kanë hyrë në kantier dhe janë kontrolluar si më lart mund t'i nënshtrohen edhe një kontrolli të detajuar kur operatori e shikon të arsyeshme. Nëse është e nevojshme, mund të merren kampione për të kryer analizën laboratorike të tyre dhe kontrolluar natyrën e mbetjeve. Mbetjet që lejohet të hyjnë në venddepozitim janë:

- mbetje të ngurta bashkiake ose shtëpiake
- mbetje komerciale të cilat kanë të njëjtat karakteristika si ato shtëpiake
- mbetje komerciale nëse i janë nënshtruar më parë një paratrajtimi për t'i kthyer në mbetje më të njëjtat karakteristika si ato shtëpiake (ndarje në burim).

Mbetjet të cilat nuk janë të pranueshme në venddepozitim janë:

- mbeturinat e rrezikshme dhe jo të rrezikshme që vijnë nga spitalet ose strukturat veterinare, ato që vijnë nga qendrat e mjekimit dhe kujdesit shëndetësor, ndërsa mund të pranohen vetëm mbeturinat që vijnë nga departamentet plotësuese, për shembull kuzhina, depot e ushqimit dhe të tjera të ngjashme
- mbetje industriale
- mbetje anijesh
- mbetje blegtorale
- mbetje në gjendje të lëngët dhe llumra/balte
- mbetje materialesh të djegshme dhe eksplozive
- mbetje radioaktive
- mbetje të përcaktuara si të rrezikshme në katalogun e mbetjeve.

Në çdo rast, mbetjet të cilat nuk përfshihen në mbetje të ngurta bashkiake apo të krahasueshme nga cilësia me mbetjet bashkiake, si ato që nuk vijnë nga kontenierët e vendosur në anë të rrugëve, por nga bizneset, zejtaria, industria, agrikultura ose shërbimet, duhet të shoqërohen me analizat e duhura të bëra nga një laborator kimik i aprovuar. Për mbetje të të njëjtit tip që vijnë nga e njëjta kompani e autorizuar, analizat që përcaktojnë tipin janë të vlefshme për një vit, në raste të tjera secila ngarkesë duhet të shoqërohet me çertifikatën e analizave. Çertifikata e analizave duhet të tregojë në mënyrë të qartë përshtatshmërinë e mbetjeve për t'u depozituar në venddepozitim.

Përsa më sipër, menaxhimi i venddepozitimit konsiston në:

- Kontrolloimin në vendosjen e shtresave të mbetjeve, ngjeshjen, mbulimin dhe respektimin e kuotave dhe pjerrësive sipas projektit teknik/vizatimeve;
- Kontrollin vazhdimisht në venddepozitim dhe sistemin e shkarkimit të ujërave me qëllim garantimin e mirëmbajtjes së rrjetit të shkarkimit dhe rrjeteve të drenazhimit të ujërave sipërfaqësore;
- Kontrollin periodikisht mirëmbajtjen e argjinaturave mbajtëse, rrethimit perimetral, portës hyrëse për në kantier;
- Kontrolli në mënyrë konstante makineritë dhe pajisjet e nevojshme për proçeset e punës që kryhen;
- Kontrolli i pompave dhe pastrami i vaskës së evaporimit dhe dekantimit.
- Pastrimi i kanalit rrethues në mënyrë periodike;
- Pastrimi i bimësisë në kanalet rrethuese;

Kufizimi i përhapjes së pluhurave dhe emëtimeve të aromave të pakëndshme në mjedis duke marrë këto masa parandaluese:

- Kufizimi i sipërfaqes së mbetjeve të ekspozuar ndaj agjentëve atmosferike në qeliza të vogla;
- Kompaktimi i mbetjeve ditore;

- Mbulimi i mbetjeve me material dheu (mbetje inerte të bluara, mbetje dherash nga gërmime të mundshme etj) në fund të ditës ose sipas periodicitetit të përcaktuar.

Kontrollimin dhe shmangien e përhapjes së insekteve dhe parazitëve duke marrë këto masa parandaluese:

- Mbulimi i sipërfaqeve me material dheu si dhe zona në të cilat konstatohen plasaritje në venddepozitim;
- Respektimi i kuotës në të gjithë sipërfaqen e venddepozitimit me qëllim evitimin e pellgjeve me ujëra të ndenjur që nxisin shumimin e insekteve;
- Realizimi i pjerrësisë së faqes ballore të mbetjeve për të nxitur rrjedhjen e ujit të shiut dhe shmangur krijimin e pellgjeve të përkohshëm, të cilët mund të destabilizojnë mbetjet dhe të pengojnë funksionimin e duhur të përditshëm të mjeteve që operojnë në venddepozitim;

Ndërkohë stafi që do të përfshihet në operacionet e manaxhimit të venddepozitimit do të jetë:
Përgjegjësi i operimit të venddepozitimit do të jetë përgjegjës për kryerjen dhe kontrollin e të gjithë operacioneve të përditshme në venddepozitim, i cili duhet të ketë njohuri për trajtimin e mbetjeve, trajtimin dhe menaxhimin e lëngut kullues, mbledhjes dhe shkarkimit të gazit si dhe aftësi për të drejtuar.
Manovratori do të jetë përgjegjës për kryerjen e operacioneve të asgjesismit të mbetjeve në venddepozitim (shtyrje, sistemim, ngjeshje dhe mbulim) si dhe mirëmbajtjen e mjeteve.
Puntorët do të sigurojnë mirëmbajtjen e shërbimeve në venddepozitim, me prerjen e barit, ngritjen e tubave, pastrimin e kanaleve të kullimit, etj.
Rojet do të sigurojnë ruajtjen e objektit dhe mund të kryejë edhe orientimin e mjeteve drejt zonës së shkarkimit, manovrimin e mjeteve për shkarkim si dhe kontrollin e mbetjeve, etj.

KOSTOT TOTALE VJETORE TË SHËRBIMEVE SHTESË TË PASTRIMIT, VEND DEPOZITIMIT DHE RICIKLIMIT :

Nr	Emërtimi	Shuma/lekë në vit
1	Shërbimet pastrimit në lagjet muzeale dhe shtratin e Lumit.	14.633.664
2	Shërbimet në venddepozitimin	4.042.527
3	Riciklimi	1.526.436
	TOTALI	**20.202.625**

1.Shenime te pergjithshme shpjeguese

<u>Per llogaritjen e kostos se sherbimit te pastrimit dhe te venddepozitimit</u>

- Ne analizat e kostos,shpenzimet per pagat e punetoreve te sherbimeve jane llogaritur sipas VKM Nr.325 date 31.05.2023 " Per pagat e Punonjesve Mbeshtetes te Institucioneve Buxhetore dhe te Nenpunesve te disa Institucioneve Buxhetore"
  Niveli I pages eshte llogaritur maksimumi I mundshem(vjetersia ne pune 25 vite)
  Per rojet eshte parashikuar shtesa mbi page,per punen e kryer jashte kohes normale te punes,ne dite festash etj.

- Ne analizat e kostos,shpenzimet per pagen e Pergjegjesit eshte llogaritur sipas VKM Nr.328 date 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore"
  Niveli I pages eshte llogaritur maksimumi I mundshem(vjetersia ne pune 25 vite).

- Ne analizat e kostos,niveli I kontributeve per sigurimet shoqerore eshte llogaritur 16.7%.

- Analizat e kostos se materialeve jane llogaritur mbi bazen e te dhenave baze,normave te konsumit sipas vleresimeve dhe informacioneve te dhena nga anetaret e komisionit sipas detyrave perkatese.

- Ne analizat e kostos,ne llogaritjen e kostos se sherbimeve eshte zbatuar cmimi I tregut te materialeve.

***Tabele shpjeguese 1**

Nr	Emertimi I produktit	Njesia e matjes	Oferta 1/leke	Oferta 2/leke	Oferta 3/leke	Cmim Mesatar
1	Veshje pune profesionale me shirita fosforeshente (kominoshe), me material pambuku	pale	1.950	1.800	1.800	1.850
2	Çizme pune të shkurtra shiu, me material PVC	pale	1.800	600	1.500	1.300
3	Doreza pune me veshje lëkure	pale	100	200	100	133
4	Pelerinë shiu me shirit fosforeshent, me material PVC	cope	1.600	1.700	1.500	1.600
5	Fshesë plastike	cope	200	1.000	160	453
6	Radap për spërkatjen 2 here te bimëve	litra	1.500	1.200	1.400	1.367
7	Syze pune	cope	800	170	750	573
8	Jelek pune	cope	200	200	175	192
9	Karrocë dore metalike (me peshë mbajtëse deri ne 100 Kg)	cope	5.000	3.500	4.100	4.200
10	Gërshërë metalike manuale për prerje bari/krasitje	cope	1.200	1.500	1.000	1.233
11	Kosë bari prej celiku special me bisht druri (me gjatësi tehu 650mm)	cope	1.800	2.000	1.600	1.800
12	Krehër bari metalik me bisht druri	cope	550	1.000	500	683
13	Pompa me bateri per sperkatje	cope	5.000	2.750	4.500	4.083
14	Prashitës metalik për bimë dhe lule me dy krahë	cope	1.000	1.000	800	933
15	Lopatë katrore celiku me bisht druri	cope	1.500	750	1.300	1.183
16	Kazma (çapa)	cope	1.500	650	1.300	1.150
17	Makine korrese	cope	25.000	10.000	20.000	18.333
18	Steka per prejren e barit me bateri	cope	50.000	15.000	42.000	35.667
19	Disqe (per steken)	cope	3.500	2.500	3.000	3.000
20	Fill (per steken)	ml	100	50	100	83
21	Drenazh/ gur me dimesion 10-15 cm	M3	900	1000	1000	967
22	Sfurqe	cope	1.500	1.000	1.300	1.267
23	Tub korrogato HDPE DN 200 mm, SN 4	m	1.000	400	800	733
24	Tel xingato d=4 mm	kg	800	150	900	617
25	Rrjete teli me dimensione 80x100 mm, d=2.7 mm me h=1.2 m, gjatesi 20 m	cope	5.000	5.000	4.500	4.833
26	Qese te zeza(120lt)	cope	199	241	198	213

*Shenim

Si me siper kemi te pasqyruar tabelen me produktet qe jane konstatuar per tu perdorur ne Studimin e pastrimit dhe venddepozitimit. Jane marre ne shqyrtim tre oferta nga biznese te ndryshme per te nxjerre nje mesatare per cmim te produktit.
Oferta nr 1 eshte marre nga subjekti Power Industries Shpk,
Oferta nr 2 eshte marre nga subjekti Agim Arapi,
Oferta nr 3 eshte marre nga 4S SHPK.

RAPORTI I MONITORIMIT TË TRANSPARENCËS SË 10 BASHKIVE DHE MATJES SË 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKËVE



Faktoje.al

RAPORTI I MONITORIMIT TË TRANSPARENCËS SË 10 BASHKIVE DHE MATJES SË 40 PREMTIMEVE TË KRYEBASHKIAKËVE

Shkurt 2021


SHKODËR
KUKËS
LEZHË
ELBASAN
BELSH
PUSTEC
FIER
PATOS
KORÇË
VLORË

Përmbajtja

HYRJE 4
TRANSPARENCA 5
METODOLOGJIA 5
PARASHIKIMET LIGJORE TË INDIKATORËVE TË MONITORUAR 6
GJETJET PËR SECILËN PREJ BASHKIVE 8
- Bashkia Belsh 8
- Bashkia Elbasan 9
- Bashkia Fier 11
- Bashkia Korçë 12
- Bashkia Kukës 13
- Bashkia Lezhë 15
- Bashkia Patos 16
- Bashkia Pustec 17
- Bashkia Shkodër 19
- Bashkia Vlorë 20

ANALIZË KRAHASUESE 22
MONITORIMI I PREMTIMEVE 23
METODOLOGJIA 23
PREMTIMET E MONITORUARA 24
GJETJET PËR SECILËN PREJ BASHKIVE 26
- Bashkia Belsh 26
- Bashkia Elbasan 26
- Bashkia Fier 27
- Bashkia Korçë 27
- Bashkia Kukës 28
- Bashkia Lezhë 28
- Bashkia Patos 29
- Bashkia Pustec 29
- Bashkia Shkodër 30
- Bashkia Vlorë 30

ANEKS 1 31
ANEKS 2 33

HYRJE

Projekti "40 premtime, 10 bashki" është mbështetur nga National Endowment for Democracy (NED) dhe i implementuar nga Qendra Faktoje. Projekti synon monitorimin e dhjetë bashkive sa i përket mbajtjes së premtimeve dhe transparencës. Bashkitë në të cilat është shtrirë projekti janë Shkodra, Lezha, Kukësi, Elbasani, Belshi, Korça, Pusteci, Vlora, Fieri dhe Patosi. Në monitorimin e këtyre bashkive janë përfshirë gazetarë lokalë, si edhe aktivistë të shoqërisë civile.

Për secilën nga bashkitë e sipërpërmendura janë përzgjedhur 4 premtime nga kryebashkiakët aktualë gjatë fushatës së fundit elektorale për zgjedhjet vendore. Këto premtime janë monitoruar në bazë të një metodologjie analitike që përfshin analizën buxhetore, monitorimin e prokurimit publik dhe vëzhgimet në terren. Nga ana tjetër, transparenca dhe konsultimi publik janë të rregulluara nga kuadri ligjor dhe nënligjor në vendin tonë, por gjejnë gjithashtu mbështetje direkte edhe në standardet ndërkombëtare. Duke qenë se në bazë të legjislacionit vendas, çdo institucion publik duhet të zbatojë programin e transparencës, projekti ka monitoruar se sa zbatohet ky program nga bashkitë e përfshira në projekt.

Ky raport synon që të përcjellë të dhëna lidhur me monitorimin e mbajtjes së premtimeve të bëra nga kryebashkiakët aktualë dhe zbatimin e programit të transparencës nga dhjetë bashki të vendit. Në raport do të gjeni metodologjinë e përdorur, gjetjet e detajuara për secilën prej tyre dhe disa rekomandime për përmirësimin e llogaridhënies dhe zbatimin e parashikimeve ligjore në lidhje me transparencën.

TRANSPARENCA

METODOLOGJIA

Detyrimet e njësive të vetëqeverisjes vendore që lidhen me procesin e konsultimit publik dhe zbatimin e transparencës janë identifikuar nëpërmjet analizës së kuadrit ligjor përkatës. Organizimi dhe funksionimi i njësive të vetëqeverisjes vendore është i rregulluar në Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ndërsa detyrimet e tyre për procesin e konsultimit publik dhe zbatimin e transparencës rregullohen më tej nga Ligji Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe Ligji Nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik". Nga parashikimet e këtyre tre ligjeve janë gjeneruar edhe 15 indikatorët për të cilët janë monitoruar dhjetë bashkitë e vendit:

- **INDIKATORI 1:** Caktimi dhe publikimi i një personi si koordinator i njoftimit dhe konsultimit publik, i cili është përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik;
- **INDIKATORI 2:** Konsultimi i buxhetit vjetor 2021 të bashkisë;
- **INDIKATORI 3:** Konsultimi i paketës së taksave dhe tarifave vendore;
- **INDIKATORI 4:** Konsultimi i tjetërsimit të pronave të bashkisë;
- **INDIKATORI 5:** Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë;
- **INDIKATORI 6:** Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjesave publike nga këshilli bashkiak në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë ;
- **INDIKATORI 7:** Njoftimi paraprakisht i datës dhe orës së mbledhjeve të këshillit bashkiak në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë;
- **INDIKATORI 8:** Njoftimi paraprakisht i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të këshillit bashkiak në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë;
- **INDIKATORI 9:** Përcaktimi dhe publikim i të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit;
- **INDIKATORI 10:** Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të bashkisë;
- **INDIKATORI 11:** Publikimi i strukturës organizative të bashkisë;
- **INDIKATORI 12:** Publikimi i buxhetit vjetor 2020 të bashkisë;
- **INDIKATORI 13:** Publikimi i vendimeve të Këshillit Bashkiak;
- **INDIKATORI 14:** Publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak;
- **INDIKATORI 15:** Publikimi i urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë.

Të dhënat e këtij raporti për monitorimin e 15 indikatorëve janë mbledhur nga gazetarët në terren. Gazetarët zhvilluan paraprakisht takime informuese me ekspertët të cilët punuan me identifikimin e indikatorëve dhe ekspertin ligjor, për t´u informuar dhe për të marrë shpjegimet përkatëse për të gjithë indikatorët, bazën ligjore të tyre dhe mënyrën e monitorimit. Pas këtij procesi informues dhe sqarues me gazetarët, këta të fundit duke pasur informacionin e duhur mbi indikatorët, mbi parashikimet ligjore të detyrimeve të bashkive për realizimin e tyre dhe burimet nga mund të merrnin informacion për secilin prej tyre, kanë analizuar faqet zyrtare të internetit të bashkive dhe kanë monitoruar stendat e njoftimeve publike të bashkive, si një mënyrë tjetër alternative që përdorin bashkitë për komunikimin me qytetarët. Gjithashtu gazetarët kanë ndjekur drejtëpërdrejtë mbledhjet e këshillit bashkiak, fizikisht dhe/ose online sipas rasteve përkatëse. Një burim tjetër i përdorur nga gazetarët për mbledhjen e të dhënave është komunikimi i drejtëpërdrejtë me bashkinë, duke kërkuar informacion.

Përveç këtij monitorimi të gazetarëve, të dhjeta bashkive të monitoruara i është dërguar shkresë zyrtare në dt.15 shkurt 2021 duke i kërkuar informacionin dhe dokumentacionin përkatës për indikatorët e mësipërm të cilët lidhen me konsultimin e akteve të miratuara dhe njoftimet që duhet të realizohen në kuadër të zhvillimit të konsultimit publik. Pavarësisht detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 15, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" ku parashikohet se institucionet duhet të kthejnë përgjigje brenda 10 ditëve pune nga dita e dorëzimit të kërkesës, 5 bashki nuk u përgjigjën.[1]

Për të bërë një renditje të bashkive të përfshira në projekt sa i përket transparencës, për secilin nga indikatorët e sipërpërmendur, atyre u është alokuar nga 1 pikë për një total prej 15 pikësh për ato bashki që plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore.

PARASHIKIMET LIGJORE TË INDIKATORËVE TË MONITORUAR

Indikatorët e monitoruar për dhjetë bashkitë e vendit janë gjeneruar nga parashikimet ligjore përkatëse të cilat rregullojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore, procesin e konsultimit publik dhe transparencën. Konkretisht janë Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligji Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe Ligji Nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik".

Ligji Nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" rregullon procesin e konsultimit publik, për të siguruar transparencën, gjithëpërfshirjen dhe realizimin në kohë të veprimeve. Ky konsultim publik, për të siguruar përfshirjen në procesin e vendimmarrjes zhvillohet për projektakte si projektligje, dokumente strategjike kombëtare dhe lokale, si dhe politika me interes të lartë publik. Parashikimet ligjore të parashikuara në këtë ligj, zbatimi i të cilave është monitoruar për bashkitë janë:

- Caktimi dhe publikimi i një personi si koordinator i njoftimit dhe konsultimit publik, i cili është përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik;[2]
- Konsultimi i buxhetit vjetor 2021 të bashkisë[3]

1 Shkresa e dërguar gjendet bashkëlidhur këtij Raporti në Aneksin 1.

2 "Çdo organ publik cakton një person si koordinator të njoftimit dhe konsultimit publik, i cili është përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik, të parashikuar nga ky ligj", Neni 10, ligji Nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"

3 *"Ky ligj rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projektdokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik",* Neni 1, ligji Nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik". Detyrimi për këtë këshillim e konsultim buron edhe nga parashikimet e ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", konkretisht nenet 18 dhe 54 të këtij ligji.

- Konsultimi i paketës së taksave dhe tarifave vendore[4]
- Konsultimi i tjetërsimit të pronave të bashkisë[5]
- Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë[6]
- Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjesave publike në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë [7]
- Njoftimi paraprakisht i datës dhe orës së mbledhjeve të këshillit bashkiak në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë[8]
- Njoftimi paraprakisht i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të këshillit bashkiak në faqen e internetit apo në stendën e njoftimeve publike të bashkisë[9]

Ligji Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Parashikimet ligjore të tij, zbatimi i të cilave është monitoruar për bashkitë janë konkretisht:

- Përcaktimi dhe publikimi i të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit[10]
- Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të bashkisë[11]
- Publikimi i strukturës organizative të bashkisë[12]
- Publikimi i buxhetit vjetor 2020 të bashkisë[13]
- Publikimi i vendimeve të Këshillit Bashkiak[14]
- Publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak[15]
- Publikimi i urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë[16]

4 Po aty.

5 Po aty.

6 *"Njoftimi për projektaktet që do t'i nënshtrohen procedurës së konsultimit publik bëhet nëpërmjet regjistrit elektronik. Në rastet kur organi publik e konsideron të nevojshme, njoftimi mund të kryhet edhe në një apo disa nga format e mëposhtme: a) me postë elektronike; b) me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik inicues; c) me një lajmërim në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale; ç) me botimin në gazeta lokale ose në dy gazetat më të lexuara në nivel kombëtar. 2. Marrja e komenteve dhe rekomandimeve në procesin e konsultimit publik kryhet në një nga format e përmendura më sipër, si dhe në raste të caktuara në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike".* Neni 1, ligji Nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik".

7 Po aty.

8 *"Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes",* neni 17, ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Përveç parashikimit në këtë ligj, dy indikatorët e fundit janë analizuar edhe në këndvështrimin e zhvillimit të konsultimit publik, ku nëpërmjet mbledhjeve të këshillit bashkiak e komisioneve, bashkia këshillohet me qytetarët.

9 Neni 54 i ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" parashikon se Këshilli bashkiak zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet. Komisioni si një nga strukturat e këshillit bashkiak ka të njëjtat detyrime kundrejt qytetarëve të njësisë, për më tepër që këshilli bashkiak ka për detyrë këshillimin me bashkësinë për krijimin e këtyre komisioneve sipas parashikimeve të neneve 18 dhe 54/a të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

10 *"Për zbatimin e këtij ligji, me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e së drejtës së informimit, autoriteti publik cakton një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit",* Neni 10, ligji Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"

11 *"Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit:* a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik; b) tekstet e plota:.. të akteve nënligjore; e) të dhëna për buxhetin", Neni 7, ligji Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"

12 Po aty

13 Po aty

14 Po aty. Zbatimi i parashikimeve të ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" referohet për detyrimin e publikimit të akteve të këshillit bashkiak drejtëpërdrejtë nga ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" në nenin 18. Në këtë nen parashikohet gjithashtu se aktet e këshillit bashkiak publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike.

15 Po aty

16 Po aty

GJETJET PËR SECILËN PREJ BASHKIVE

BASHKIA BELSH

Për Bashkinë Belsh janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkie për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë. Tabelat 1 dhe 1.1, në aneksin 2 përmbajnë informacion të përmbledhur për realizimin e indikatorëve dhe linket përkatëse të faqes zyrtare të internetit të Bashkisë.

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Belsh e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e një personi si koordinator i njoftimit dhe konsultimit publik.	✓
2	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Belsh nuk e ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor 2021 të Bashkisë. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe nga stendat e njoftimit, nuk janë publikuar njoftime për zhvillimin e proceseve konsultuese për buxhetin vjetor 2021 të Bashkisë.	✗
3	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Belsh nuk e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve nuk janë konstatuar realizime aktivitetesh për përmbushjen e këtij detyrimi.	✗
4	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve nuk janë konstatuar realizime aktivitetesh për përmbushjen e këtij detyrimi. Faktikisht, Bashkia mund të mos ketë realizuar tjetërsime pronash. Kërkesës për informacion mbi këtë çështje, bashkia nuk iu përgjigj, ndaj po e cilësojmë si indikator të parealizuar.	✗
5	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Belsh nuk ka të publikuar në internet njoftimin për zhvillimin e një seance publike, por i takon Dhjetorit 2017. Nuk ka njoftime për zhvillim të seancave publike në një periudhe të mëvonshme.	✗
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjesave publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Belsh nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe nuk ka publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjesave publike nga këshilli bashkiak.	✗
7	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Belsh ka vendosur në stendat e njoftimeve, njoftime paraprake lidhur me zhvillimin e mbledhjeve të këshillit bashkiak. Këto njoftime nuk gjenden në faqen zyrtare të internetit.	✓
8	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Belsh ka vendosur në stendat e njoftimeve, njoftime paraprake lidhur me mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak. Këto njoftime nuk gjenden në faqen zyrtare të internetit.	✓
9	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Belsh e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit. Këto të dhëna janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë.	✓

10	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Belsh e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	✓
11	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Belsh e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	✓
12	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Belsh e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor 2020 të bashkisë. Në faqen zyrtare të Bashkisë janë publikuar buxhetet vjetore të periudhës 2019-2020.	✓
13	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Belsh e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak. Megjithatë, vendimet më të fundit të publikuara janë ato të miratuara në Maj 2020, duke mos qenë të përditësuara me vendimet e miratuara në periudhën e mëvonshme.	✗
14	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Belsh nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	✗
15	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Belsh nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë	✗
16	**Totali i Realizimit**		**46.6%**

BASHKIA ELBASAN

Për Bashkinë Elbasan janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkie për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë. Tabelat 2 dhe 2.1, në aneksin 2 përmbajnë informacion të përmbledhur për realizimin e indikatorëve dhe linket përkatëse të faqes zyrtare të internetit të Bashkisë.

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Elbasan e ka realizuar pjesërisht detyrimin për realizimin e procesit të konsultimit publik, pasi në faqen zyrtare të internetit ka shënuar adresën e e-mailit në të cilën qytetarët mund të përcjellin mendimet dhe sugjerimet e tyre, konkretisht në adresën konsultimipublik@elbasani.gov.al. Por nuk ka të publikuar të dhënat e kontaktit të personit të caktuar si koordinator i njoftimit dhe konsultimit publik.	✗
2	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Elbasan ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor 2021 të Bashkisë nëpërmjet zhvillimit të dëgjesave publike të organizuara në kuadër të planit të aktiviteteve për takimet mbi "Buxhetimin me pjesëmarrje" në Bashkinë Elbasan.	✓
3	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve nuk janë konstatuar realizime aktivitetesh për përmbushjen e këtij detyrimi.	✗

4	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Elbasan nuk e ka konsultuar me qytetarët tjetërsimin e pronave të bashkisë. Faktikisht, Bashkia mund të mos ketë realizuar tjetërsime pronash. Kërkesës për informacion mbi këtë çështje, bashkia nuk iu përgjigj, ndaj po e cilësojmë si indikator të parealizuar.	✗
5	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Elbasan ka të publikuar në internet njoftime për realizimin e seancave për konsultim publik, si në rastin e realizimit të këtyre konsultimeve me praninë fizike të qytetarëve, ashtu edhe me përcjelljen e mendimeve nëpërmjet postës elektronike. Njoftimet më të fundit për zhvillimin e këtyre seancave i përkasin Nëntorit 2020 për konsultimin e buxhetit vjetor 2021.	✓
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjesave publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Elbasan nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe nuk publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime lidhur me zhvillimin e dëgjesave publike nga këshilli bashkiak.	✗
7	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Elbasan nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe nuk publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	✗
8	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Elbasan nuk e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit. Këto të dhëna janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë.	✗
9	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Elbasan e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit. Këto të dhëna janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë.	✓
10	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Elbasan e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	✓
11	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Elbasan e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	✓
12	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Elbasan e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor 2020 të bashkisë. Në faqen zyrtare të Bashkisë janë publikuar buxhetet vjetore të periudhës 2008-2021.	✓
13	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Elbasan e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak. Vendimet më të fundit të publikuara janë ato të miratuara në Dhjetor 2020.	✓
14	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Elbasan nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak	✗
15	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Elbasan nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë	✗
16	**Totali i Realizimit**		**46.6%**

BASHKIA FIER

Për Bashkinë Fier janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkie për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë. Tabelat 3 dhe 3.1, në aneksin 2 përmbajnë informacion të përmbledhur për realizimin e indikatorëve dhe linket përkatëse të faqes zyrtare të internetit të Bashkisë.

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Fier e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e një personi si koordinator i njoftimit dhe konsultimit publik.	✓
2	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Fier ka konsultuar me qytetarët buxhetin vjetor nëpërmjet zhvillimit të dëgjesave publike të organizuara.	✓
3	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Fier nuk e ka konsultuar me qytetarët paketën e taksave dhe tarifave vendore. Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve nuk janë konstatuar realizime aktivitetesh për përmbushjen e këtij detyrimi.	✗
4	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Nga vëzhgimi i faqes së internetit dhe i stendave të njoftimeve nuk janë konstatuar realizime aktivitetesh për përmbushjen e këtij detyrimi. Faktikisht, Bashkia mund të mos ketë realizuar tjetërsime pronash. Kërkesës për informacion mbi këtë çështje, bashkia nuk iu përgjigj, ndaj po e cilësojmë si indikator të parealizuar.	✗
5	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Fier nuk ka të publikuar në internet apo në stendën e njoftimeve, asnjë njoftim për organizimin e seancave për konsultim publik.	✗
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjesave publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Fier publikon njoftime për dëgjesat publike në faqen Facebook, por jo në faqen e internetit.	✗
7	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Fier nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe nuk ka publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak.	✗
8	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Fier nuk ka vendosur në stendat e njoftimeve dhe nuk ka publikuar në faqen zyrtare të internetit, njoftime paraprake lidhur me njoftimet për mbledhjet e komisioneve të këshillit bashkiak.	✗
9	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Fier e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit. Këto të dhëna janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë.	✓
10	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Fier e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	✓
11	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Fier e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	✓

12	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Fier e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor 2020 të bashkisë. Në faqen zyrtare të Bashkisë janë publikuar buxhetet vjetore të periudhës 2016-2021.	✓
13	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Fier nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak.	✗
14	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Fier nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	✗
15	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Fier nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë.	✗
16	**Totali i Realizimit**		**40%**

BASHKIA KORÇË

Për Bashkinë Korçë janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkie për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë. Tabelat 4 dhe 4.1, në aneksin 2 përmbajnë informacion të përmbledhur për realizimin e indikatorëve dhe linket përkatëse të faqes zyrtare të internetit të Bashkisë.

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e një personi si koordinator i njoftimit dhe konsultimit publik.	✓
2	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për konsultimin e buxhetit vjetor 2021 të Bashkisë.	✓
3	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për konsultimin e paketës së taksave dhe tarifave vendore.	✓
4	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për konsultimin e tjetërsimit të pronave të bashkisë.	✓
5	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për publikimin e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultim publik.	✓
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjesave publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për njoftimin për organizimin e dëgjesave publike nga këshilli bashkiak.	✓
7	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për njoftimin paraprakisht të datës dhe orës së mbledhjeve të këshillit bashkiak	✓

8	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për njoftimin paraprakisht të datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të këshillit bashkiak.	✓
9	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit. Këto të dhëna janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë.	✓
10	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	✓
11	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	✓
12	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor 2020 të bashkisë. Në faqen zyrtare të Bashkisë janë publikuar buxhetet vjetore të periudhës 2014-2021.	✓
13	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Korçë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak. Vendimet më të fundit të publikuara janë ato të miratuara në Dhjetor 2020.	✓
14	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Korçë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak	✗
15	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Korçë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë	✗
16	**Totali i Realizimit**		**86.6%**

BASHKIA KUKËS

Për Bashkinë Kukës janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkie për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë. Tabelat 5 dhe 5.1, në aneksin 2 përmbajnë informacion të përmbledhur për realizimin e indikatorëve dhe linket përkatëse të faqes zyrtare të internetit të Bashkisë.

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Kukës nuk e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e një personi si koordinator i njoftimit dhe konsultimit publik.	✗
2	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Kukës e ka realizuar detyrimin për konsultimin e buxhetit vjetor 2021 të Bashkisë.	✓
3	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Kukës e ka realizuar detyrimin për konsultimin e paketës së taksave dhe tarifave vendore.	✓
4	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Kukës nuk ka pasur procese të tjetërsimit të pronave të Bashkisë, si rrjedhojë ky indikator nuk gjen aplikim.	✓

5	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Kukës e ka realizuar pjesërisht detyrimin për publikimin e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultim publik, duke vendosur kalendarin e dëgjesave publike në faqen zyrtare të internetit, por përcakton në ato njoftime vetëm muajin dhe vitin. Nuk ka informacione të tjera si dita dhe ora e zhvillimit të seancave konsultuese.	✗
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjesave publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Kukës nuk e ka realizuar detyrimin për njoftimin për organizimin e dëgjesave publike nga këshilli bashkiak.	✗
7	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Kukës e ka realizuar detyrimin për njoftimin paraprakisht të datës dhe orës së mbledhjeve të këshillit bashkiak, duke bërë publikimet përkatëse në stendën e njoftimeve. Këto njoftime nuk gjenden të publikuara në faqen zyrtare të internetit.	✓
8	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Kukës nuk e ka realizuar detyrimin për njoftimin paraprakisht të datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të këshillit bashkiak	✗
9	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Kukës e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit. Këto të dhëna janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë.	✓
10	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Kukës e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	✓
11	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Kukës e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	✓
12	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Kukës e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor 2020 të bashkisë. Në faqen zyrtare të Bashkisë janë publikuar buxhetet vjetore të periudhës 2020-2021.	✓
13	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Kukës e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak. Vendimet më të fundit të publikuara janë ato të miratuara në 25 Janar 2021.	✓
14	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Kukës nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak	✗
15	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Kukës nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë. Urdhri më i fundit i publikuar është miratuar në 3 Nëntor 2015.	✗
16	**Totali i Realizimit**		**60%**

BASHKIA LEZHË

Për Bashkinë Lezhë janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkie për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë. Tabelat 6 dhe 6.1, në aneksin 2 përmbajnë informacion të përmbledhur për realizimin e indikatorëve dhe linket përkatëse të faqes zyrtare të internetit të Bashkisë.

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Lezhë e nuk ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e një personi si koordinator i njoftimit dhe konsultimit publik.	✗
2	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për konsultimin e buxhetit vjetor 2021 të Bashkisë, përmes publikimit të një pyetësori online.	✓
3	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për konsultimin e paketës së taksave dhe tarifave vendore.	✓
4	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për konsultimin për tjetërsimin e pronave të Bashkisë.	✓
5	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Lezhë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultim publik. Njoftimi më i fundit i publikuar në faqen zyrtare të internetit është i vitit 2016.	✗
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjesave publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Lezhë nuk e ka realizuar detyrimin për njoftimin për organizimin e dëgjesave publike nga këshilli bashkiak. Në përgjigje të kërkesës për informacion, Bashkia ka argumentuar se pandemia është bërë shkak për këtë mungesë, ndonëse konsultimi publik mund të realizohej në rrugë digjitale si në rastin e buxhetit.	✗
7	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për njoftimin paraprakisht të datës dhe orës së mbledhjeve të këshillit bashkiak, duke bërë publikimet përkatëse në faqen zyrtare të internetit.	✓
8	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Lezhë nuk e ka realizuar detyrimin për njoftimin paraprakisht të datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të këshillit bashkiak	✗
9	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit. Këto të dhëna janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë.	✓
10	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	✓
11	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	✓
12	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor 2020 të bashkisë. Në faqen zyrtare të Bashkisë janë publikuar buxhetet vjetore të periudhës 2014-2020.	✓

13	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Lezhë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak. Vendimet më të fundit të publikuara janë ato të miratuara në Dhjetor 2020.	✓
14	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Lezhë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak	✗
15	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Lezhë nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë. Urdhri më i fundit i publikuar është miratuar në 3 Nëntor 2015.	✗
16	**Totali i Realizimit**		**60%**

BASHKIA PATOS

Për Bashkinë Patos janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkie për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë. Tabelat 8 dhe 8.1, në aneksin 2 përmbajnë informacion të përmbledhur për realizimin e indikatorëve dhe linket përkatëse të faqes zyrtare të internetit të Bashkisë.

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Patos e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e një personi si koordinator të njoftimit dhe konsultimit publik.	✓
2	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Patos e ka realizuar detyrimin për konsultimin e buxhetit vjetor 2021 të Bashkisë.	✓
3	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Patos nuk e ka realizuar detyrimin për konsultimin e paketës së taksave dhe tarifave vendore.	✗
4	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Patos nuk ka pasur tjetërsim pronash e rrjedhimisht ky detyrim ligjor konsiderohet i realizuar.	✓
5	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Patos e ka realizuar detyrimin për publikimin e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultim publik.	✓
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjesave publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Patos e ka realizuar detyrimin për njoftimin për organizimin e dëgjesave publike nga këshilli bashkiak.	✓
7	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Patos e ka realizuar detyrimin për njoftimin paraprakisht të datës dhe orës së mbledhjeve të këshillit bashkiak, duke bërë publikimet përkatëse në faqen zyrtare të internetit.	✓
8	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Patos e ka realizuar detyrimin për njoftimin paraprakisht të datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të këshillit bashkiak	✗

9	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Patos e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit. Këto të dhëna janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë.	✓
10	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Patos e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	✓
11	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Patos e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	✓
12	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Patos e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor 2020 të bashkisë. Në faqen zyrtare të Bashkisë janë publikuar buxhetet vjetore të periudhës 2019-2021.	✓
13	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Patos e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak.	✓
14	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Patos e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak	✓
15	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Patos nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë.	✗
16	**Totali i Realizimit**		**80%**

BASHKIA PUSTEC

Për Bashkinë Pustec janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkie për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë. Tabelat 7 dhe 7.1, në aneksin 2 përmbajnë informacion të përmbledhur për realizimin e indikatorëve dhe linket përkatëse të faqes zyrtare të internetit të Bashkisë..

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Pustec nuk e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e një personi si koordinator të njoftimit dhe konsultimit publik.	✗
2	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Pustec e ka realizuar detyrimin për konsultimin e buxhetit vjetor 2021 të Bashkisë.	✓
3	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Pustec nuk e ka realizuar detyrimin për konsultimin e paketës së taksave dhe tarifave vendore.	✗
4	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Pustec nuk ka pasur tjetërsim pronash e rrjedhimisht ky detyrim ligjor konsiderohet i realizuar.	✓
5	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Pustec e ka realizuar detyrimin për publikimin e njoftimeve për organizimin e seancave për konsulitm publik, duke bërë njoftimet përkatëse në stendën e njoftimeve publike.	✓

6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjesave publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Pustec e ka realizuar detyrimin për njoftimin për organizimin e dëgjesave publike nga këshilli bashkiak.	✓
7	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Pustec e ka realizuar detyrimin për njoftimin paraprakisht të datës dhe orës së mbledhjeve të këshillit bashkiak	✓
8	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Pustec nuk e ka realizuar detyrimin për njoftimin paraprakisht të datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të këshillit bashkiak	✗
9	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Pustec nuk e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit. Këto të dhëna nuk janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë.	✗
10	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Pustec e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	✓
11	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Pustec nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë. E ka të publikuar në stendë, por jo në faqen zyrtare siç parashikohet në ligjin përkatës.	✗
12	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Pustec nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor 2020 të bashkisë.	✗
13	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Pustec e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak. Vendimet më të fundit të publikuara janë ato të miratuara në Dhjetor 2020.	✓
14	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Pustec nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak	✗
15	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Pustec nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë	✗
16	**Totali i Realizimit**		**40%**

BASHKIA SHKODËR

Për Bashkinë Shkodër janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkie për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë. Tabelat 9 dhe 9.1, në aneksin 2 përmbajnë informacion të përmbledhur për realizimin e indikatorëve dhe linket përkatëse të faqes zyrtare të internetit të Bashkisë.

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e një personi si koordinator të njoftimit dhe konsultimit publik.	✓
2	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për konsultimin e buxhetit vjetor 2021 të Bashkisë.	✓
3	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për konsultimin e paketës së taksave dhe tarifave vendore.	✓
4	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për konsultimin për tjetërsimin e pronave të Bashkisë.	✓
5	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultim publik. Njoftimi më i fundit i përket datës 21 Janar 2021.	✓
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjesave publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për njoftimin për organizimin e dëgjesave publike nga këshilli bashkiak.	✓
7	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për njoftimin paraprakisht të datës dhe orës së mbledhjeve të këshillit bashkiak, duke bërë publikimet përkatëse në faqen zyrtare të internetit.	✓
8	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për njoftimin paraprakisht të datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të këshillit bashkiak	✓
9	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit. Këto të dhëna janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë.	✓
10	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	✓
11	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	✓
12	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor 2020 të bashkisë. Në faqen zyrtare të Bashkisë janë publikuar buxhetet vjetore të periudhës 2013-2021.	✓
13	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak. Vendimet më të fundit të publikuara janë ato të miratuara në 28 Janar 2021.	✓

14	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Shkodër nuk e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak	✗
15	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Shkodër e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë. Urdhëri më i fundit i publikuar është miratuar në 3 Shtator 2020.	✓
16	**Totali i Realizimit**		**93.3%**

BASHKIA VLORË

Për Bashkinë Vlorë janë monitoruar të gjithë indikatorët sipas metodologjisë së përshkruar më sipër dhe gjetjet e kësaj Bashkie për secilin prej këtyre indikatorëve janë si më poshtë. Tabelat 10 dhe 10.1, në aneksin 2 përmbajnë informacion të përmbledhur për realizimin e indikatorëve dhe linket përkatëse të faqes zyrtare të internetit të Bashkisë.

Nr	Indikatori	Komente	Statusi
1	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e një personi si koordinator i njoftimit dhe konsultimit publik. Në faqen e internetit gjendet emri i Fabiola Deliajt.	✓
2	Konsultimi publik i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për konsultimin e buxhetit vjetor 2021 të Bashkisë.	✓
3	Konsultimi publik i paketës së taksave dhe tarifave vendore	Bashkia Vlorë nuk e ka realizuar detyrimin për konsultimin e paketës së taksave dhe tarifave vendore.	✗
4	Konsultimi publik i vendimeve për tjetërsimin e pronave të Bashkisë	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për konsultimin për tjetërsimin e pronave të Bashkisë, konsultimi i fundit i realizuar është në datën 8 shkurt 2020.	✓
5	Vendosja e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultimin publik në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për publikimin e njoftimeve për organizimin e seancave për konsultim publik.	✓
6	Vendosja e njoftimeve për organizimin e dëgjesave publike nga Këshilli Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për njoftimin për organizimin e dëgjesave publike nga këshilli bashkiak.	✓
7	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për njoftimin paraprakisht të datës dhe orës së mbledhjeve të këshillit bashkiak, duke bërë publikimet përkatëse në faqen zyrtare të internetit dhe facebook.	✓
8	Njoftimi i datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të Këshillit Bashkiak në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike	Bashkia Vlorë nuk e ka realizuar detyrimin për njoftimin paraprakisht të datës dhe orës së mbledhjeve të komisioneve të këshillit bashkiak.	✗
9	Caktimi dhe publikimi i të dhënave për Koordinatorin për të Drejtën dhe Informimin	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për caktimin dhe publikimin e të dhënave të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit. Këto të dhëna janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë.	✓

10	Publikimi i Programit të Transparencës në faqen e internetit të Bashkisë	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të Programit të Transparencës.	✓
11	Publikimi i Strukturës Organizative të Bashkisë	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të strukturës organizative të bashkisë.	✓
12	Publikimi i buxhetit vjetor të Bashkisë	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të internetit të buxhetit vjetor 2020 të bashkisë. Në faqen zyrtare të Bashkisë janë publikuar buxhetet vjetore të periudhës 2014-2020.	✓
13	Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të vendimeve të këshillit bashkiak. Vendimet më të fundit të publikuara janë ato të miratuara në Dhjetor 2020.	✓
14	Publikimi i Proces-Verbaleve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të procesverbaleve të mbledhjeve të këshillit bashkiak.	✓
15	Publikimi i Urdhërave dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë	Bashkia Vlorë e ka realizuar detyrimin për publikimin në faqen zyrtare të urdhërave dhe vendimeve të kryetarit të bashkisë. Urdhëri më i fundit është 12 shkurt 2021.	✓
16	**Totali i Realizimit**		**86.6%**

ANALIZË KRAHASUESE

Në tabelën më poshtë janë përmbledhur rezultatet e monitorimit për të dhjetë bashkitë e monitoruara, të renditura sipas rezultatit në indeksin e transparencës. Bashkia me performancën më të lartë është ajo e Shkodrës me 93.3% e ndjekur nga Bashkia e Korçës dhe Vlorës, të cilat kanë realizuar kërkesat e legjislacionit sa i përket transparencës në masën 86.6% duke realizuar 13 nga 15 indikatorët e matur. Ndërkohë, bashkitë me performancën më të dobët janë Bashkitë e Pustecit dhe Fierit, të cilat kanë realizuar vetëm 6 nga 15 indikatorët e matur duke arritur një rezultat prej 40%.

Nr	Bashkia	Indeksi i Transparencës
1	Bashkia Shkodër	93.3%
2	Bashkia Korçë	86.6%
3	Bashkia Vlorë	86.6%
4	Bashkia Patos	80.0%
5	Bashkia Kukës	60.0%
6	Bashkia Lezhë	60.0%
7	Bashkia Belsh	46.6%
8	Bashkia Elbasan	46.6%
9	Bashkia Fier	40.0%
10	Bashkia Pustec	40.0%

Sa u përket indikatorëve, vërehet se të dhjeta bashkitë e monitoruara e kanë publikuar Programin e Transparencës në faqen e tyre të internetit. Ndërkohë, nëntë nga dhjetë bashkitë e monitoruara kanë caktuar dhe publikuar të dhënat për Koordinatorin për të Drejtën e Informimit, edhe pse vetëm gjashtë nga dhjetë bashkitë e monitoruara, kanë caktuar Koordinatorin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Bashkitë kanë një performancë të mirë në konsultimin publik të Buxhetit Vjetor dhe në publikimin e tij në faqen e internetit. Në këtë mënyrë, nëntë nga dhjetë bashkitë e monitoruara kanë realizuar konsultime publike për hartimin e buxhetit dhe e kanë publikuar buxhetin vjetor 2020. Performanca nuk është aspak e mirë sa i përket konsultimeve publike për paketën e taksave dhe tarifave vendore, ku vetëm katër nga dhjetë bashkitë e monitoruara kanë zhvilluar konsultime publike për këtë çështje.

Sa i përket transparencës së Këshillit Bashkiak, tetë nga dhjetë bashkitë e monitoruara kanë njoftuar datën dhe orën e Mbledhjes së Këshillit, Bashkiak. Vetëm dy nga dhjetë bashkitë e monitoruara kanë publikuar Proces-Verbalet e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak. Nga ana tjetër, shtatë nga dhjetë bashkitë e monitoruara kanë publikuar Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe vetëm pesë nga dhjetë bashkitë e monitoruara kanë publikuar njoftime për realizimin e konsultimeve publike nga ana e Këshillit Bashkiak.

Transparenca është shumë e ulët sa i përket publikimit të Vendimeve dhe Urdhërave të Kryetarit të Bashkisë. Vetëm dy nga dhjetë bashkitë e monitoruara i kanë publikuar urdhërat apo vendimet e Kryetarit.

MONITORIMI I PREMTIMEVE

Ekipi i Faktoje përzgjodhi katër premtime të bëra gjatë fushatës elektorale të vitit 2019 për secilën nga Bashkitë pjesë e projektit për të monitoruar përmbushjen e tyre (përjashtim bën vetëm bashkia e Lezhës, me një premtim që lidhet me çështjen jetike, siç është strehimi pas tërmetit të 26 nëntorit). Për monitorimin e këtyre premtimeve është ndjekur metodologjia e mëposhtme:

METODOLOGJIA

Premtimet për shërbimet publike mund të ndahen në dy grupe të mëdha:

1. Premtimet që lidhen me aktet administrative mbi uljen apo heqjen e taksave e tarifave apo për kthimin e një hapësire publike në pedonale, apo për hapjen e një qendre sociale, kinemaje, etj.

2. Mbajtja e këtyre premtimeve realizohet përmes miratimit të akteve administrative ligjore si Vendimet dhe Urdhërat e Kryetarit të Bashkisë dhe Vendimet e Këshillit Bashkiak. Disa prej këtyre premtimeve kanë efekte financiare dhe për këtë duhet analizuar edhe buxheti për të parë nëse janë parashikuar fonde për ngritjen e një strukture të re;

   Premtimet që lidhen kryesisht me infrastrukturën publike që përbëjnë detyrat dhe kompetencat kryesore të bashkive si ujësjellësi dhe kanalizimet, rrugët dhe hapësirat e gjelbra, shkollat dhe kopshtet, qendrat shëndetësore, qendrat sociale dhe godinat e tjera publike, etj. Mbajtja e këtyre premtimeve lidhet ngushtësisht me buxhetin e bashkive.

Për të analizuar dhe dokumentuar mbajtjen e këtyre premtimeve fillimisht duhet parë nëse ato janë përfshirë në buxhetin e Bashkisë, më saktësisht në "Shpenzimet Kapitale" apo në "Shpenzimet e Mirëmbajtjes".

Megjithatë, edhe nëse janë përfshirë në buxhet, nuk do të thotë se premtimet do të mbahen, pasi bashkitë pothuajse gjithmonë nuk i përmbahen angazhimeve të buxhetit. Prandaj është me rëndësi që të shihet edhe nëse një bashki ka bërë ose planifikon të bëjë prokurimin publik për projektin në fjalë. Plani i prokurimeve mund të shihet në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Vlen të theksohet se realizimi i disa prej këtyre premtimeve mund të bëhen edhe në bashkëpunim apo me ndihmën e institucioneve të tjera, si Ministritë e Linjës, psh, Ministria e Shëndetësisë për qendrat shëndetësore apo AKUM për ujësjellësat apo landfillet. Prandaj është e rëndësishme që të studiohen edhe buxhetet dhe prokurimet e këtyre institucioneve për të parë nëse e kanë përfshirë këtë projekt apo jo. Si rrjedhim, në bazën e të dhënave parashikohet të ekzistojë edhe seksioni "Institucion tjetër i përfshirë" për të identifikuar dhe monitoruar edhe këto institucione që mund të financojnë plotësisht apo bashkë-financojnë me bashkitë implementimin e këtyre projekteve.

Indikatorët që u maten, sa u takon Shërbimeve Publike, janë:

1. Vendimet dhe Urdhërat e Kryetarit të Bashkisë;
2. Vendimet e Këshillit Bashkiak;
3. Buxheti;
4. Plani i Prokurimeve;
5. Lista e Kontratave të Shpallura;
6. Buxheti i Institucioneve të tjera të Përfshira dhe plani i tyre i prokurimeve.

PROJEKTET E MËDHA

Projektet e mëdha përfshijnë projekte që kërkojnë një financim shumë të madh krahasuar me buxhetin e një bashkie dhe kërkojnë domosdoshmërisht përfshirjen dhe financimet e Qeverisë Qendrore. Në këto projekte përfshihen Autostradat dhe Rrugët Kombëtare, Portet, Aeroportet dhe Terminalet, Spitalet, Teatrot, Stadiumet, etj.

Këto projekte, pavarësisht se mund të jenë premtuar nga Kryebashkiakët, faktikisht janë jashtë kompetencave të Bashkisë. Por, premtimi i kryetarëve mund të lidhet edhe me lobimin pranë Qeverisë apo Ministrive për financimin e këtyre projekteve. Prandaj, për monitorimin e realizimit të këtyre premtimeve duhet të monitorohet buxheti dhe plani i prokurimeve i institucionit qendror e jo i bashkisë.

Indikatorët që u maten, sa u takon Projekteve të Mëdha, janë:

Buxheti i Institucioneve qëndrore në varësi të fushës, si psh. Ministrisë së Shëndetsisë për spitalet, FSHF/MASR për stadiumet, FSHZH apo ARRSH për rrugët, etj.

Për monitorimin e realizimit të këtyre premtimeve, Ekipi i Faktoje ndërmori hapat e mëposhtme:

1. Analiza e buxhetit të bashkive;
2. Analiza e Planit të Prokurimeve;
3. Dërgimi i kërkesave për informacion pranë bashkive;
4. Realizimi i vizitave në terren për të parë gjendjen nga afër.

PREMTIMET E MONITORUARA

Premtimet e përzgjedhura për secilën nga Bashkitë e përfshira në projekt janë si më poshtë.

BASHKIA BELSH

- Ndërtimi i qendrave shëndetësore në zonat rurale;
- Rikonstruksioni i kopshteve dhe shkollave;
- Ndërtimi i ujësjellësit në Belsh;
- Rikonstruksioni i qendrës së qytetit dhe kurorës së gjelbër.

BASHKIA ELBASAN

- Realizimi i investimeve në Gjinar;
- Monitorimi i ndotjes dhe shtimi i hapësirave të gjelbra;
- Rindërtimi i infrastrukturës së lagjeve të qytetit;
- Shtimi i parqeve dhe hapësirave të gjelbra.

BASHKIA FIER

- Ndalimi i ndotjes në Lumin e Gjanicës;
- Ndërtimi i një terminali modern autobusësh;
- Rikonstruksioni i Teatrit "Bylis";
- Ndërtimi i Pallatit të Sportit.



BASHKIA KORÇË

- Ndërtimi i Pallatit të Sportit dhe Stadiumit të ri;
- Ndërtimi i infrastrukturës në Ravonik;
- Ndërtimi i muzeut të rakisë dhe pishinës së qytetit;
- Ndërtimi i pistave të skive në Dardhë dhe Voskopojë.

BASHKIA KUKËS

- Ndërtimi i një landfilli rajonal për Kukësin;
- Ndërtimi i infrastrukturës në Borje;
- Rindërtimi i infrastrukturës së brendshme të Lagjeve Nr. 1 dhe Nr. 2;
- Infrastruktura rrugore dhe e ujësjellësit në Topojan.

BASHKIA LEZHË

- Rindërtimi i dy pallateve të dëmtuara nga tërmeti;
- Rikonstruksioni i rrugëve të brendshme;
- Pastrimi i kanaleve kulluese;
- Furnizimi me energji elektrike i Torovicës.

BASHKIA PUSTEC

- Ndërtimi i një qendre shëndetësore;
- Zgjidhja e problemit të trajtimit të mbetjeve;
- Zgjidhja e problemit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve;
- Realizimi i investimeve në infrastrukturë.

BASHKIA PATOS

- Ndërtimi i Pyllit Orbital;
- Ndërtimi i kanalizimeve në Grizë, Zharrëz dhe Frashër;
- Rikonstruksioni i qendrës së Kuqarit;
- Ndërtimi i rrugëve Drenie-Siqece dhe Ruzhdie-Gjinoqare.

BASHKIA SHKODËR

- Ndërtimi i qendrave komunitare;
- Mbulimi i territorit me transport urban;
- Ndërtimi i korsive të biçikletave;
- Banesa sociale për personat me statusin e jetimit.

BASHKIA VLORË

- Furnizimi me ujë 24 orë në ditë i Vlorës;
- Ndërtimi i Banesave Sociale;
- Zgjidhja e problemit të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve;
- Rikonstruksioni i Teatrit "Petro Marko".

GJETJET PËR SECILËN PREJ BASHKIVE

BASHKIA BELSH

Premtimi	Komente	Statusi
Ndërtimi i qendrave shëndetësore në zonat rurale	Ndërtimi i qendrave shëndetësore nuk është përgjegjësi e pushtetit lokal. Megjithatë, nga komunikimi me bashkinë dhe vizita në terren rezulton se janë ndërtuar 3 qendra shëndetësore, ndërkohë që janë 6 fshatra që nuk e kanë një të tillë.	Premtim i pambajtur
Rikonstruksini i kopshteve dhe shkollave	Në Bashkinë Belsh gjenden 7 kopshte, 16 shkolla 9-vjeçare dhe 3 shkolla të mesme. Ndërkohë që gjatë 5 viteve të fundit janë rikonstruktuar vetëm 2 shkolla dhe 1 kopsht. Duke u nisur nga buxheti që ka në dispozicion është e pamundur që ky premtim të mbahet.	Premtim i pambajtur
Ndërtimi i ujësjellësit në Belsh	Projekti për ujësjellësin është financuar nga Qeveria Shqiptare. Megjithatë, projekti përfshin vetëm qytetin dhe në shumë fshatra të Bashkisë ende ka probleme me furnizimin me ujë.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Rikonstruksioni i qendrës së qytetit dhe kurorës së gjelbër	Qendra e qytetit të Belshit është rikonstruktuar plotësisht me financim nga Qeveria e Shqipërisë.	Premtim i mbajtur

BASHKIA ELBASAN

Premtimi	Komente	Statusi
Realizimi i investimeve në Gjinar	Bashkia nuk ka parashikuar investime në buxhetin e saj për këtë zone turistike, ndërkohë që në përgjigjen për Faktoje deklaron se ka realizuar vetëm mirëmbajtje dhe pritet që investimet të realizohen nga qeveria në kuadrin e projektit "100 fshatrat".	Premtim i pambajtur
Monitorimi i ndotjes dhe shtimi i hapësirave të gjelbra	Projekti për monitorimin e ndotjes është financuar nga FZHR dhe është realizuar në vitin 2016, kurse sa i përket shtimit të hapësirave të gjelbra sidomos përreth ish-kombinatit metalurgjik nuk është realizuar asnjë investim.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Rindërtimi i infrastrukturës së lagjeve të qytetit	Bashkia nuk ka parashikuar investime në lidhje me infrastrukturën e brendshme të lagjeve të qytetit. Vizita në terren e ekipit të Faktoje vërteton se në këto lagje nuk është investuar prej vitesh.	Premtim i pambajtur
Shtimi i pareve dhe hapëriave të gjelbra	Analiza e Buxhetit tregon se nuk është parashikuar investim në asnjë kënd lojërash. Faktojes bashkia iu përgjigj se ende po identifikohen zonat ku mund të ndërtohen këndet e lojërave.	Premtim i pambajtur

BASHKIA FIER

Premtimi	Komente	Statusi
Ndalimi i ndotjes në Lumin e Gjanicës	Impianti i inaguruar për filtrimin e ujërave të lumit Gjanica rezultoi se ishte thjesht një demonstrimin nga një kompani private dhe Bashkia as ka nënshkruar marrëveshje me këtë kompani e as ka parashikuar investime në këtë drejtim.	Premtim i pambajtur
Ndërtimi i një terminali modern autobuzash	Terminali i ndërtuar është thjesht një strukturë metalike e ndërtuar jo si projekt më vete, por si shtesë e projektit për rikonstruksionin e një rruge. Terminali, përveç kësaj strukture, nuk ka asnjë element tjetër nga çfarë duhet të ketë sipas parashikimit.	Premtim i pambajtur
Rikonstruksioni i Teatrit Bylis	Punimet për rikonstruksionin e plotë të teatrit kanë nisur në mesin e vitit 2019, ndaj premtimi do të cilësohet si i mbajtur.	Premtim i mbajtur
Ndërtimi i Pallatit të Sportit	Bashkia ka prezantuar projektin e Pallatit të Sportit në mars të vitit 2019. Në projekt-buxhetin afatmesëm bashkia ka parashikuar fonde për ndërtimin e këtij pallati në vitin 2021 dhe 2022. Duke qenë se punimet ende nuk kanë nisur, premtimi do të cilësohet si i pambajtur.	Premtim i pambajtur

BASHKIA KORÇË

Premtimi	Komente	Statusi
Ndërtimi i Pallatit të Sportit dhe Stadiumit të ri	Bashkia nuk ka parashikuar investime për këto projekte dhe kërkesës për informacion iu përgjigj se ato janë në fazën e projekt-idesë, pra ende nuk janë realizuar projektet e detajuara. Në këto kushte, duket e pamundur që ato të përmbushen brenda manadatit 4-vjeçar.	Premtim i pambajtur
Ndërtimi i infrastrukturës në Ravonik	Nga informacioni i marrë nga Bashkia dhe vizita në terren u vu re që janë realizuar disa investime të pjesshme, ndaj edhe premtimi do të cilësohet si pjesërisht i mbajtur.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Ndërtimi i muzeut të rakisë dhe pishinës	Bashkia nuk ka parashikuar investime për këto projekte. Kërkesës për informacion iu përgjigj se pishina është në fazën e projekt-idesë ndërsa për muzeun nuk ka ende një projekt dhe nuk është prioritar për bashkinë.	Premtim i pambajtur
Ndërtimi i pisateve të skive në Dardhë dhe Voskopojë	Bashkia nuk ka parashikuar investime në buxhet për këto projekte e as nuk ka hartuar projekt-idetë. Në këto kushte, duket e pamundur që ato të përmbushen brenda manadatit 4-vjeçar.	Premtim i pambajtur

BASHKIA KUKËS

Premtimi	Komente	Statusi
Ndalimi i ndotjes në Lumin e Ndërtimi i një landfilli rajonal për Kukësin	Me mbështetjen e donatorëve të huaj është hartuar Projekti dhe Studimi i Fizibilitetit. Megjithatë, deri në momentin e verifikimit, ende nuk ishtë gjetur financimi për këtë projekt.	Premtim i pambajtur
Ndërtimi i infrastrukturës në Borje	Bashkia nuk ka parashikuar investime në buxhetin e saj për këtë fshat. Nga vizita në terren rezultoi se nuk është mbajtur.	Premtim i pambajtur
Rindërtimi i infrastrukturës së brendshme të Lagjeve Nr. 1 dhe Nr. 2	Bashkia nuk ka parashikuar investime për infrastrukturën e këtyre dy lagjeve dhe nuk iu përgjigj kërkesës për informacion nga Faktoje. Nga vizita në terren rezultoi se në këto dy lagje nuk është kryer asnjë investim.	Premtim i pambajtur
Infrastruktura rrugore dhe e ujësjellësit në Topojan.	Bashkia nuk ka parashikuar investime në buxhetin e saj për këtë fshat. Nga vizita në terren rezultoi se premtimet për ujësjellësin dhe infrastrukturën rrugore nuk janë mbajtur.	Premtim i pambajtur

BASHKIA LEZHË

Premtimi	Komente	Statusi
Rindërtimi i dy pallateve të dëmtuara nga tërmeti	Nga vëzhgimi në terren rezulton se njëri nga pallatet nuk është shembur ende, ndërsa tjetri është shembur, por ende nuk ka nisur puna për rindërtimin e tij.	Premtim i pambajtur
Rikonstruksioni i rrugëve të brendshme	Zbatimi i projekteve rikonstruktuese ende nuk ka nisur. Bashkia iu përgjigj Faktojes se pritet që në vitin 2021 të nisë një projekt me financim nga KfW për ndërtimin e ujësjellësit dhe kanalizimeve dhe më pas do të investohet për rikonstruksionin e infrastrukturës.	Premtim i pambajtur
Pastrimi i kanaleve kulluese	Bashkia ka realizuar pastrimin e kanaleve kulluese në zonat Torovicë dhe Barbullojë, por ende bashkia nuk ka një zgjidhje gjithëpërfshirëse për këtë problematikë.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Furnizimi me energji elektrike i Torovicës	Furnizimi me energji elektrike është jashtë kompetencave të pushtetit lokal. Megjithatë, furnizimi me energji në Torovicë ende nuk ka pasur asnjë investim dhe gjendja vazhdon njësoj si më parë.	Premtim i pambajtur

BASHKIA PATOS

Premtimi	Komente	Statusi
Ndërtimi i Pyllit Orbital	Pavarësisht se gjatë fushatës elektorale, Kryebashkiakja shprehej se projekti ishte gati, në përgjigjen për Faktoje Bashkia deklaroi se ky projekt nuk është i realizueshëm pasi territori i bashkisë është mjaft i vogël.	Premtim i pambajtur
Ndërtimi i kanalizimeve në Grizë, Zharrëz dhe Frashër	Bashkia nuk ka parashikuar investime në buxhetin e saj për këto fshatra. I vetmi investim i prokuruar lidhet me ujësjellësin e qytetit Patos.	Premtim i pambajtur
Rikonstruksioni i qendrës së Kuqarit	Bashkia nuk ka parashikuar investime për këtë projekt, as për realizimin e projektit arkitekturor e as për ndërtimin e tij.	Premtim i pambajtur
Ndërtimi i rrugëve Drenie-Siqece dhe Ruzhdie-Gjinoqare	Bashkia shprehet se në rrugën Ruzhdie-Gjinoqare është investuar në 2016-n, ndërkohë që në rrugën Drenie-Siqece është investuar për mirëmbajtjen. Megjithatë, gjendja në këtë të fundit lë për të dëshiruar siç u konstatua pas vizitës në terren.	Premtim pjesërisht i mbajtur

BASHKIA PUSTEC

Premtimi	Komente	Statusi
Ndërtimi i një qëndre shëndetësore	Ndërtimi i qendrave shëndetësore nuk është përgjegjësi e pushtetit lokal, por e Ministrisë së Shëndetësisë. Sidoqoftë, duke qenë se ende në Pustec nuk ka pasur asnjë investim në këtë drejtim, premtimi do të klasifikohet i pambajtur	Premtim i pambajtur
Zgjidhja e problemit të trajtimit të mbetjeve	Bashkia nuk ka parashikuar fonde apo invesime në këtë drejtim. Kërkesës për informacion nga Faktoje iu përgjigj se është duke negociuar një marrëveshje me landfillin e Maliqit. Sidoqoftë, vizita në terren tregoi se trajtimi i mbejteve vazhdon të bëhet pa asnjë lloj standardi mjedisor	Premtim i pambajtur
Zgjidhja e problemit të ujit të pishëm dhe kanalizimeve	Edhe pse gjatë vizitës në terren, Bashkia u shpreh se nuk kishte ende një projekt gati, në datën 31.12.2020 shpalli tenderin me vlerë mbi 456 milionë lek për ndërtimin e ujësjellësit.	Premtim i mbajtur
Realizimi i investimeve në infrastrukturë.	Bashkia ka pak fonde në dispozicion për realizimin e infrastrukturës rrugore ndaj nuk ka parashikuar investime në buxhet. Ky premtim do të cilësohet i pambajtur.	Premtim i pambajtur

BASHKIA SHKODËR

Premtimi	Komente	Statusi
Ndërtimi i qendrave komunitare	Nga vëzhgimi në terren rezulton se në Bashkinë Shkodër janë hapur dhe janë plotësisht operacionale 5 qendra komunitare të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme sociale për komunitetin.	Premtim i mbajtur
Mbulimi i territorit me transport urban	Aktualisht në qytetin e Shkodrës funksionon vetëm një linjë e transportit urban. Pavarësisht se Bashkia ka konceptuar pesë linja të tjera dhe ka hapur garën për to, ato ende nuk janë funksionale.	Premtim i pambajtur
Ndërtimi i korsive të biçikletave	Bashkia ka hartuar dhe miratuar një plan për lëvizjen me biçikletë, ndërkohë që investimet në infrastrukturë ende nuk kanë nisur. Sipas komunikimit me Faktoje bashkia parashikon që të nisë shumë shpejt investimin pasi fondet janë parashikuar në buxhet.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Banesa sociale për personat me statusin e jetimit	Bashkia ka nisur që në vitin 2017 implementimin e projektit për kthimin e ish-konviktit të pyjores në banesa sociale. Pas shumë vonesave, projekti është thuajse i përfunduar dhe në momentin e verifikimit nga Faktoje ishte duke u analizuar dokumentacioni i aplikuesve.	Premtim i mbajtur

BASHKIA VLORË

Premtimi	Komente	Statusi
Furnizimi me ujë 24 orë në ditë i Vlorës	Këshilli Bashkiak ka miratuar disa projekte të rëndësishme sa i përket furnizimit me ujë, ndërkohë që Bashkia ka shpallur tenderin e rikonstuksionit të ujësjellësit në Novoselë, por ende nevojiten shumë investime për realizimin e furnizimit me ujë 24 orë.	Premtim pjesërisht i mbajtur
Ndërtimi i Banesave Sociale	Projekti për Ndërtimin e banesave sociale është duke u implementuar me financim të Entit Kombëtar të Banesave	Premtim i mbajtur
Zgjidhja e problemit të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve në ish-Fushën e Aviacionit	Në qershor të vitit 2020 u shpall fituesi i tenderit për ndërtimin e landfillit të Vlorës me financim nga KfW. Megjithatë në ish-Fushën e Aviacionit vazhdon depozitimi i mbejteve dhe ajo nuk është kthyer në një park siç ishte premtuar	Premtim i pambajtur
Rikonstruksioni i Teatrit Petro Marko	Bashkia nuk ka parashikuar në buxhetin e saj fonde për rikonstruksionin e Teatrit, por shprehet se ka kërkuar financim nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Ende nuk është hartuar një projekt për rikonstruksionin e Teatrit	Premtim i pambajtur

ANEKS 1

Kërkesa për informacion dërguar 10 bashkive të monitoruara

KËRKESË

15.02.2020
KËRKUES: Inva HasanAliaj
Adresa:Nasi Pavllo, Pallati Edil_al.
Email:invahasanaliaj@faktoje.al

DREJTUAR: Bashkisë_ Belsh, Elbasan, Fier, Korçë, Kukës, Lezhë, Patos, Pustec, Shkodër, Vlorë

BAZA LIGJORE:

- Neni 10 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut
- Neni 19 i Paktit Ndërkombëtar mbi te Drejtat Civile dhe Politike
- Neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë"
- Ligji nr.119 dt. 18.09.2014 "Për të Drejtën e Informimit"

Në bazë të parashikimeve ligjore të akteve të renditura më sipër, kërkoj ju lutem informacionin dhe dokumentacionin përkatës për pyetjet më poshtë:

1. A është konsultuar me publikun Buxheti Vjetor 2020 dhe 2021 i Bashkisë? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e dëgjesave publike, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura, kopje të rekomandimeve dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.
2. A është konsultuar me publikun paketa e taksave dhe tarifave vendore për periudhën 2020-2021? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e dëgjesave publike, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura, kopje të rekomandimeve dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.
3. A është konsultuar me publikun tjetërsimi i pronave të Bashkisë për periudhën Janar 2020-Shkurt 2021? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e dëgjesave publike, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura, kopje të rekomandimeve dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.
4. A janë njoftuar paraprakisht në faqen e internetit ose stendën e informimit data dhe ora e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak për periudhën Janar 2020-Shkurt 2021? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e këtyre mbledhjeve, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.
5. A janë njoftuar paraprakisht në faqen e internetit ose stendën e informimit data dhe ora e mbledhjeve të Komisioneve të Këshillit Bashkiak për periudhën Janar 2020-Shkurt 2021? Nëse

po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e këtyre mbledhjeve, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.

6 A shfaqen në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike, njoftime për organizimin e Dëgjesave Publike nga Këshilli Bashkiak për periudhën Janar 2020-Shkurt 2021? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/njoftimeve për zhvillimin e këtyre dëgjesave, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet, kopje të procesverbaleve të mbajtura dhe dokumente të tjera që mbështesin realizimin e këtij procesi.

